

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5601
E shtunë, 13 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Limaj i kërkon Shqipërisë rishikimin e tarifës për taksën rrugore

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

'MOS TË KEMI FRIKË TË
NEGOCIOJMË, POR JO TË
NEGOCIOJMË PA PASUR
FRIKË' (J. F. Kennedy) F. 11

Prof. Lisen
BASHKURTI



JO
PARASHIKIMEVE
ME LAJME TË
ZEZA?! F. 8



Nga Jakup KRASNIQI

STUDENTËT E INFERMIERISË
TË AAB-së FIRMOSIN
KONTRATA PËR PUNË NË
TREGUN GJERMAN F. 6

EKONOMI



INSTITUCIONET E VENDIT
PREMTOJNË SE DO TA
RRISIN MBËSHTETJEN PËR
TË RINJTË NOVATORË F. 9

ATK-ja GRUMBULLON 336
MILIONË EURO TË HYRA PËR
PERIUdhËN JANAR-SHTATOR F. 8

SPORT

KASTRIOTI, PRISHTINA DHE
BESA NË EVROPË F. 20

BYLBYL SOKOLI FALËNDERON
TË GJITHË NË KF LLAPI, POR
JO DREJTORIN BATATINA F. 20

FLET PËR "EPOKËN E RE", TAULANT KRYEZIU F. 4-5

Lobimi për viza të koncentrohet te vendet kryesore të BE-së

Kryetari i Bordit Ekzekutiv të Institutit EPIK, Taulant Kryeziu, ka ftuar institucionet e Kosovës që lobimin për liberalizimin e vizave ta koncentrojnë te vendet kryesore të Bashkimit Evropian. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se vetëm përmes kontakteve diplomatike mund të largohet çdo skepticizëm i vendeve anëtare të BE-së për këtë proces. Kryeziu është shprehur optimist se mbledhja e Këshillit të BE-së, e cila do të mbahet më 6 dhe 7 dhjetor do të sjell lajmin e shumëpritur nga qytetarët e Kosovës. Sa i përket fushatës për liberalizimin e vizave që ka nisur këto ditë, Kryeziu ka thënë që pret që fushata të kontribuoj pozitivisht në informimin e qytetarëve për obligimet që rrjedhin pas marrjes së liberalizimit vizave në mënyrë që të ruhet integriteti i këtij procesi



Thellohen përplasjet në mes të LDK-së dhe PDK-së për dialogun

Procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë ka qenë arsyeja që të premtën të kundërshtohen nga distanca drejtuesit e LDK-së dhe të PDK-së. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se kjo parti nuk do të bashkëpunojë për dialogun, por kërkon matje të PDK-së në elektorat. Ndaj kësaj deklarate ka reaguar zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, duke thënë se jo çdoherë në politikë Mustafa ka bërë lëvizjet dhe zgjedhjet më të mira F. 7



Komisionarja
e BE-së:
Kosova ka
plotësuar
kriteret për
liberalizim të
vizave F. 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi takoi homologun e vet armen, Armen Sarkissian

PRISHINË, 12 TETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të premten ka zhvilluar një takim me presidentin e Armenisë, Armen Sarkissian, i cili është nikoqir i liderëve në Samitin e 17 të Frankofonisë.

Thaçi e ka falënderuar homologun e vet armen për mikpritjen dhe organizimin e shkëlqyer të Samitit të Frankofonisë, ku Kosova arriti të bëhet anëtare e asociuar e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë.

Presidenti Thaçi dhe homologu i tij armen kanë diskutuar për çështje të interesit të përbashkët ndërmjet dy shteteve dhe janë pajtuar ta vazhdojnë komunikimin e ndërsjellë edhe në të ardhmen.



Limaj i kërkon Shqipërisë rishikimin e tarifës për taksën rrugore

Në takim me ministrin e Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati, zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka kërkuar nga Qeveria shqiptare ta rishikojë edhe një herë çështjen e çmimit të taksës rrugore sepse, sipas tij, është e papranueshme vendosja e kësaj tarife kaq të lartë për qytetarët dhe për bizneset. Në këtë takim është diskutuar për mbledhjen e përbashkët të dy qeverive shqiptare që do të mbahet muajin e ardhshëm në Pejë



TIRANË, 12 TETOR - Një delegacion i Qeverisë së Kosovës, i kryesuar nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Tiranë. Delegacioni i Qeverisë së Kosovës është pritur nga ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj. Në këtë takim është diskutuar për mbledhjen e përbashkët të dy qeverive shqiptare që do të mbahet muajin e ardhshëm në Pejë. Në fjalën e tij, zëvendëskryeministri Limaj ka kërkuar nga Qeveria shqiptare ta rishikojë

edhe një herë çështjen e çmimit të taksës rrugore sepse, sipas tij, është e papranueshme vendosja e kësaj tarife kaq të lartë për qytetarët dhe për bizneset. Po ashtu, Limaj ka kërkuar edhe heqjen e skanerit për kontrollin që u bëhet bizneseve të Kosovës që kalojnë nëpër Shqipëri, e që u shkakton kosto shtesë bizneseve. "Jemi të shqetësuar me vendosjen e çmimit të taksës rrugore në 'Rrugën e Kombit'. Qytetarët e Kosovës nuk e kanë pritur mirë

vendosjen e kësaj tarife dhe ne bashkërisht duhet ta gjejmë një zgjidhje dhe ta tejkalojmë. Po ashtu, duhet t'i heqim barrierat që po pengojnë bizneset tona, siç është çështja e skanerit", ka thënë Limaj. Në këtë mbledhje përfaqësuesit e dy qeverive janë pajtuar për një sërë marrëveshjesh që do të nënshkruhen në mbledhjen e ardhshme të dy qeverive. Kësaj, në mbledhjen që do të mbahet në Pejë, gjasat janë që të nën-

shkruhet marrëveshja e cila i mundëson Kosovës një portë hyrje në portin e Durrësit. Po ashtu, marrëveshja për lëvizjen e lirë të qytetarëve andej e këndej kufirit, marrëveshja për njohjen reciproke të patentshoferëve, marrëveshja për heqjen e romingut, pastaj marrëveshja për heqjen e barrierave jotarifore si dhe të krijohet një grup punues i përbërë nga dy qeveritë i cili do të diskutonte për çështjen e tarifës rrugore dhe skanerit.

Limaj ka kërkuar nga Qeveria shqiptare themelimin e një zyre në Prizren për zhdoganimin e prodhimeve me origjinë nga Kosova dhe Shqipëria. Pjesë e delegacionit të Qeverisë së Kosovës në këtë mbledhje, përveç Limajt, ishin edhe zëvendëskryeministri Dardan Gashi, ministri Bejtush Gashi dhe Endrit Shala, zëvendësministri Fatmir Gashi dhe Rexhep Kadriu si dhe drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha.

Hoxha: BE-ja ta njohë progresin e shteteve të Ballkanit Perëndimor

PRISHINË, 12 TETOR - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, po merr pjesë në konferencën ndërkombëtare në Maribor të Sllovenisë, "Parlamenti i Adriatikut", ku po marrin pjesë personalitete nga të gjitha vendet e Ballkanit. Ministria Hoxha po merr pjesë në panelin me temë "Ku është BE: Zgjerimi në fokus", ku së bashku me ekspertët e rajonit do ta trajtojnë këtë temë. Me këtë rast ajo ka theksuar se është koha e fundit që BE-ja të zgjerohet me vendet e Ballkanit Perëndimor sepse

nga kjo përfiton edhe vetë BE-ja. Ministria Hoxha, po ashtu, është fokusuar në nevojën që vendet e Ballkanit Perëndimor të jenë pjesë e dinamikës së zgjerimit dhe sfidat brenda BE-së të mos ndikojnë negativisht në planet e zgjerimit. "Strategjia e Zgjerimit, e cila u publikua muaj më parë, dha një mesazh të qartë për perspektivën evropiane të kësaj pjese të Evropës e cila është më se e mirëpritur në të gjitha vendet duke na inkurajuar në të njëjtën kohë për t'i ndërmarrë



rë reformat e nevojshme drejt integritimit. Ajo që është e rëndësishme për vendet e Ballkanit është të kemi një

gjuhë më të qartë dhe më specifike mbi perspektivën evropiane. BE-ja duhet ta mbajë fjalën dhe ta kryejë pjesën e vet të obligimeve", ka deklaruar ministria Hoxha. Sipas saj, ndër vlerat fundamentale të BE-së është edhe fqinjësia e mirë dhe perspektiva e përbashkët zhvillimore, ekonomike, arsimore, tregtare, transportit, konkurrueshmërisë, ambientit dhe sferat e tjera, por edhe përball trendëve negativë globalë, siç janë papunësia, varfëria, epidemitë, ngrohja globale apo terrorizmi.

Thellohen përplasjet në mes të LDK-së dhe PDK-së për dialogun



Procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë ka qenë arsyeja që të premtën të kundërshtohen nga distanca drejtuesit e LDK-së dhe të PDK-së. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se kjo parti nuk do të bashkëpunojë për dialogun, por kërkon matje të PDK-së në elektorat. Ndaj kësaj deklarate ka reaguar zëvendëskryetari i PDK-së, Enver Hoxhaj, duke thënë se jo çdoherë në politikë Mustafa ka bërë lëvizjet dhe zgjedhjet më të mira. Megjithatë, sipas Hoxhajt, Kuvendi është vendi për t'u bërë bashkë në procesin e dialogut ku LDK-ja duhet të bashkohet në takimet dhe diskutimet e ardhshme për ta nxjerrë më të mirën

marrëveshjen për demarkacionin me Malin e Zi. E votuan për interes të qytetarëve, jo për merita të koalicionit qeverisës. Sepse krejt Kosova e di se kush e pengoi demarkacionin dhe liberalizimin e vizave. E penguan me kauza të rrejshme dhe veprime të dhunshme ata që sot qeverisin vendin", ka deklaruar lideri i LDK-së, Isa Mustafa.

Kësaj deklarate të liderit të LDK-së i është kundërpërgjigjur zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, duke thënë se jo çdoherë në politikë Isa Mustafa ka bërë lëvizjet dhe zgjedhjet më të mira. Sipas Hoxhajt, Mustafa i mbetet borxh elektoratit të LDK-së t'ia shpjegojë pse i pranon në shtëpi ata që e gjuajtën me koktej molotovi, vezë e gaz lotsjellës në çdo ditë të punës së tij. "Kam pasur dhe ende kam respekt për Isa Mustafën si profesor dhe politikan. Megjithëse, jo çdoherë në politikë ai ka bërë lëvizjet dhe zgjedhjet më të mira. Në një reagim të tij sot për zhvillimet aspak të këndshme lidhur me pamundësinë e votimit të demarkacionit nga qeveria e udhëhequr prej tij, duke sulmuar PDK-në, do të ndalem në dy momente. E para, vendimmarrja e tij si kryeministër asokohe u bllokua nga një pjesë e partisë së tij, e cila jo vetëm se i doli kundër demarkacionit, por as nuk e votoi atë për kryeministër. E dyta, Isa Mustafa po ankohet në një pjesë të qeverisë aktuale që, sipas tij, udhëhoqi protesta të dhunshme kundër demarkacionit para dy vjetësh. Por ai i mbetet borxh elektoratit të LDK-së t'ia shpjegojë pse i pranon në shtëpi ata që e gjuajtën me koktej molotovi, vezë e gaz lotsjellës në çdo ditë të punës së tij", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Megjithatë, ai është pajtuar me konstatimin e Mustafës, se duhet të gjetur një nyjë besimi për t'u bërë bashkë në procesin e dialogut me Serbinë dhe, sipas Hoxhajt, është pikërisht Kuvendi i Kosovës ku LDK-ja duhet të bashkohet në takimet dhe diskutimet e ardhshme për të nxjerrë më të mirën e mundshme. "Në fund, pajtohem me kryetarin e LDK-së që duhet gjetur një nyjë besimi për t'u bërë bashkë në procesin e dialogut me Serbinë. Për PDK-në është Kuvendi i Kosovës ku LDK-ja duhet të bashkohet në takimet dhe diskutimet e ardhshme për ta nxjerrë më të mirën e mundshme", ka theksuar Hoxhaj.

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 12 TETOR - Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të premtën ka bërë me dije se kjo parti nuk do të bashkëpunojë me partitë në pushtet për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se një gjë të tillë e pamundëson mungesa e besimit ndërmjet forcave politike sepse, sipas Mustafës, pa besim reciprok nuk ecin temat e mëdha. Kryetari i LDK-së vazhdon të insistojë për zgjedhje të reja, duke ftuar PDK-në që të maten në elektorat. "LDK-ja nuk bashkëpunon me këtë koa-

licion në procesin e dialogut, sepse nuk i beson. Ne e themi qartë se nuk ikim nga përgjegjësia jonë për vendin, por rrjedhimisht nuk ndajmë përgjegjësi me ata që u treguan të papërgjegjshëm. As nuk bëjmë marrëveshje me njerëz të cilëve nuk u besojmë. LDK-ja, dhe unë kryetar i saj, do të dëshironim që të ekzistonte një nyjë e besimit ndërmjet forcave politike në Kosovë. Pa besim reciprok nuk ecin temat e mëdha. LDK-ja ju fton: ejani të matemi në zgjedhje, i respektojmë rregullat, pastaj rreshtohemi për dialog me një qeveri të shumicës, me përfshirje të gjerë dhe platformë që merr besimin

e 2/3 të deputetëve të Kuvendit", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas kryetarit Mustafa, bashkëpunimi për dialog me Serbinë nuk mund të bëhet duke e akuzuar LDK-në se po lufton për pushtet dhe kolltukë. "Në fakt, oreksi për pushtet dhe zhveshja nga çdo normë e përgjegjësisë e PDK-së dhe e kryetarit të saj me organizimin e mocionit të mosbesimit së bashku me ata që e kallën Kosovën për dy vjet me radhë, që na gjuajtën me vezë, me gaz lotsjellës, me shishe molotovi, që na sulmuan shtëpitë dhe familjet, e sollën vendin në këtë

gjendje ku jemi. Pa një mazhorancë qeverisëse, me një qeveri e cila çdo ditë merr vendime (të mëdha) skandaloze mbi vendimet skandaloze të ditës paraprake. Kryetari i PDK-së dhe zëvendësi i tij krekoseshin dhe vazhdojnë të krekosen se e rrëzuan qeverinë e drejtuar nga LDK-ja, ku ishin edhe vetë, sepse nuk kishte guxim të marrë vendime të mëdha. Ne u themi atyre sot, urdhëroni ju dhe merrni vendime të mëdha, nëse mundeni!", është shprehur Mustafa, duke shtuar se për LDK-në problemi nuk qëndron as te pushteti e as te kolltukët kur është fjala te temat me interes të vendit. "Deputetët tanë e votuan

Flet për "Epokën e re", Taulant Kryeziu

Lobimi për viza të koncentrohe

Kryetari i Bordit Ekzekutiv të Institutit EPIK, Taulant Kryeziu, ka ftuar institucionet e Kosovës që lobimin për liberalizimin e vizave ta koncentrojnë te vendet kryesore të Bashkimit Evropian. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se vetëm përmes kontakteve diplomatike mund të largohet çdo skepticizëm i vendeve anëtare të BE-së për këtë proces. Kryeziu ka shprehur optimizëm se mbledhja e Këshillit të BE-së, e cila do të mbahet më 6 dhe 7 dhjetor, do ta sjellë lajmin e shumëpritur nga qytetarët e Kosovës. Sa i përket fushatës për liberalizimin e vizave që ka nisur këto ditë, Kryeziu ka thënë se pret që fushata të kontribuojë pozitivisht për informimin e qytetarëve për obligimet që rrjedhin pas marrjes së liberalizimit të vizave në mënyrë që të ruhet integriteti i këtij procesi

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 TETOR - Kryetari i Bordit Ekzekutiv të Institutit EPIK, Taulant Kryeziu, ka bërë me dije se mbledhja e Këshillit të BE-së, e cila do të mbahet më 6 dhe 7 dhjetor, do të jetë kryesore për liberalizim të vizave. Ai i ka ftuar institucionet e Kosovës që deri në atë çast ta koncentrojnë lotimin te vendet kryesore të BE-së për këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kryeziu ka thënë se përmes kontakteve diplomatike Kosova duhet të largojë çdo hezitim të vendeve anëtare të BE-së për liberalizim të vizave. "Lufta e vërtetë diplomatike duhet të koncentrohet te vendet kryesore të BE-së e që në bazë të votimit në Parlamentin Evropian, kemi parë që shtetet si Holanda, Franca dhe Gjermania kanë hezitime, gjë të cilën pak a shumë e kam paralajmëruar tash e shtatë muaj", ka thënë Kryeziu.

Ai ka shprehur optimizëm se vendimi i Këshillit të Ministrave të BE-së do të jetë pozitiv. Megjithatë, Kryeziu i ka ftuar liderët institucionalë të mos japin data për këtë proces ngaqë, sipas tij, vendim politik përfundimtar është i vendeve anëtare të BE-së. "Unë dua të jem optimist për hir të qytetarëve tanë, të rinisë tonë, të gjeneratave më të moshuara që, së paku, vendimmarrja të përfundojë këtë vit, e që i bie të kemi një vendim të këshillit në përbërje të ministrave të brendshëm apo drejtësisë më 6 apo 7 dhjetor", është shprehur ai.

Më tej, Kryeziu ka treguar edhe për procedurën e cila ka mbetur të zhvillohet deri në fund të këtij procesi. "Në fund të muajit të kaluar në Kosovë qëndroj një del-

egacion i COWEB. COWEB është format në nivel të ekspertëve të vendeve anëtare të BE-së, i cili është filtri i parë i vendimmarrjes politike që zhvillohet në kuadër të Këshillit. Pas shqyrtimit në nivelin e ekspertëve të COWEB-it vendimmarrja do të procedohet në nivel të ambasadorëve, në atë çfarë quhet COREPER, dhe krejt në fund kulmon me votimin në kuadër të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave duhet ta miratojë propozim-ndryshimin e Rregullores 539/2001 me atë që quhet shumicë e dyfishtë, që i bie 55 për qind e vendeve anëtare që përfaqësojnë 65 % të popullsisë", është shprehur ai. Kryeziu ka folur edhe për fushatën e institucioneve për qytetarët e Kosovës rreth procesit të liberalizimit të vizave. "Sa i përket fushatës për liberalizimin e vizave, pres që fushata të kontribuojë pozitivisht për informimin e qytetarëve për obligimet që rrjedhin pas marrjes së liberalizimit vizave në mënyrë që të ruhet integriteti i këtij procesi. Mirëpo dëmi që po shkaktohet në sistemin e drejtësisë nuk mund të evitohet me fushatë informues", është shprehur Kryeziu.

"Epoka e re": Z. Kryeziu, Qeveria e Kosovës dhe qytetarët janë në pritje të vendimit të Këshillit të BE-së për liberalizim të vizave. Si njohës i integriteteve evropiane, si e pritni këtë vendim?

Kryeziu: Mbledhja e Këshillit të BE-së, e fundit për këtë vit, është më 6 dhe 7 dhjetor dhe do të jetë kryesore për ta jetësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë.

"Epoka e re": Çfarë duhet të bëjnë institucionet tona gjatë kësaj kohe, në mënyrë që të mos kemi ndonjë surprizë jo të kënd-



shme në fund të procesit? Sa duhet të punohet me vendet anëtare veç e veç?

Kryeziu: Lufta e vërtetë diplomatike duhet të koncentrohet te vendet kryesore të BE-së, që në

bazë të votimit në Parlamentin Evropian kemi parë që shtetet si Holanda, Franca dhe Gjermania

t te vendet kryesore të BE-së

"Epoka e re": Ndonëse Qeveria është e bindur se vendimi do të jetë pozitiv për viza, së fundi janë shprehur disa shqetësime se mund të ndodhë ndonjë shtyrje eventuale e këtij procesi. Janë reale këto shqetësime?

Kryeziu: Për datën e saktë të lëvizjes së lirë do t'i ftoja përfaqësuesit institucionalë që të jenë të përbajtur dhe të mos rrisin pritshmërinë të qytetarët sepse ky është vendim politik i vendeve të BE-së. Nga ana tjetër, sundimi i së drejtës mbetet një nga sfidat kryesore në procesin e liberalizimit të vizave dhe integritet evropian. Çdoherë kur ne japim shembuj negativë të mosrespektimit të ligjit, siç kemi bërë gjatë gjithë kësaj kohe, ku sistemi i drejtësisë vazhdon të ndikohet nga politika në çdo mënyrë të mundshme, kjo vetëm është hap mbrapa dhe dëshmi që dëmton rënd jo vetëm këtë proces, por tërë projektin tonë për të qenë një ditë vend anëtar i BE-së. Një gjë e tillë është evidentuar dhe rikohimuar në të gjitha raportet kredibile ndërkombëtare. Së fundi, edhe draftrezoluta e Komitetit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian (AFET) për Raportin e Komisionit për Kosovën 2018 potencoi ngecjet në fushën e sundimit të ligjit. Draftrezoluta e bën të qartë që në procesin e liberalizimit të vizave luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe menaxhimi efektiv i migrimit jo të rregullt, është crucial për këtë proces.

"Epoka e re": Liderët institucionalë kanë ftuar spektrin politik të jetë unik në qëndrime gjatë takimeve me zyrtarët e vendeve anëtare të BE-së. Shfaqja e diferencave në mes të pozitës dhe opozitës në këto takime, sa mund të ndikojë në këtë proces?

Kryeziu: Në fund të muajit të kaluar në Kosovë qëndroi një delegacion i COWEB-it. COWEB është format në nivel të ekspertëve të vendeve anëtare të BE-së, i cili është filtri i parë i vendimarrjes politike që zhvillohet në kuadër të Këshillit. Pas shqyrtimit në nivelin e ekspertëve të COWEB-it, vendimarrja do të procedojë në nivel ambasadorëve në atë çfarë quhet COREPER, e krejt në fund kulmon me votimin në kuadër të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave duhet ta miratojë propozim-ndryshimin e Rregullores 539/2001 me atë që quhet shumicë e dyfishtë, që i bie 55 për qind e vendeve anëtare që përfaqësojnë 65 për qind të popullsisë. Gjithsesi, unë dua të jem optimist për hir të qytetarëve tanë, të rinisë sonë, të gjeneratave më të moshuara që,

së paku, vendimarrja të përfundojë këtë vit, e që i bie të kemi një vendim të këshillit në përbërje të ministrave të brendshëm apo drejtësisë më 6 apo 7 dhjetor.

"Epoka e re": Institucionet kanë lansuar fazën e re të fushatës për liberalizimin e vizave, e cila ka për qëllim t'i informojë qytetarët se çfarë është dhe çfarë nuk është liberalizimi i vizave. Nëse ndodh ky proces, pritni që të

keqpërdoret nga qytetarët e Kosovës?

Kryeziu: Sa i përket fushatës për liberalizimin e vizave, pres që fushata të kontribuojë pozitivisht për informimin e qytetarëve për obligimet që rrjedhin pas marrjes së liberalizimit të vizave në mënyrë që të ruhet integriteti i këtij procesi. Mirëpo dëmi që po shkaktohet në sistemin e drejtësisë nuk mund të evitohet me fushatë informues, pasi ajo varet nga vullneti politik

për t'i dhënë frymëmarrje sistemit të drejtësisë, ku politika nuk ka vend në të. Prandaj, fushata më e mirë do të ishte që politika ta ndërpresë njëherë e përgjithmonë ndikimin në sistemin e drejtësisë dhe ta kuptojë njëherë e mirë që pa drejtësi të pavarur, efikase dhe transparente, me njerëz me kredibilitet, nuk mund ta bindim asnjë kryeqytet të BE-se që ne jemi vend i denjë për të qenë pjesë e klubit evropian.

Thaçi nuk heq dorë: Korrigjimi i kufijve, deri në pranverën tjetër

PRISHTINË, 12 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shprehur optimizëm se deri në pranverën e ardhshme do të arrihet marrëveshja me Serbinë që do ta përfshijë korrigjimin e kufijve. Në një intervistë për televizionin francez "France 24", Thaçi ka theksuar se ndryshimi i kufijve nuk është ideja që ai dëshiron ta prezantojë por se, pas negociatave të deritanishme, kjo

është zgjidhja e vetme e mençur për stabilitetin e dy vendeve. Ai ka thënë se marrëveshja do të duhet ta përbajë njohjen e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në Këshillin e Sigurisë së OKB-së. Ndërsa ka siguruar se nëse ndodh një marrëveshje e tillë, me të cilën Kosova do të bëhej shtet shumetnik, të drejtat e serbëve të Kosovës do të respektohen. "Ideja ime për korrigjim të

kufijve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, nëse nuk do ta nënkuptonte arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare me njohje reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB, në fakt sfidon reziqë të tjera të ndarjes së Kosovës apo themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që nënkupton 'Republika Serpska'", ka thënë Thaçi.



kanë hezitime, të cilën pak a shumë e kam paralajmëruar tash e shtatë muaj.

Jo parashikimeve me lajme të zeza?!



Nga Jakup KRASNIQI

Krerët e institucioneve të Kosovës nuk janë aty ku janë për falltarë. Falltarë që parashikojnë lajme të këqija, aty ku janë për të dhënë lajme të mira, bile edhe këto ogure vetëm pasi janë marrë vendimet e mira, vendime që bëjnë zgjidhje të mira për publikun. Kosovës, në të gjitha mediet e saj, lajme të zeza i servohen nga mëngjesi në mbrëmje nga Serbia, të përcjella me fotot e Vuçiqit e të Daçiqit për çdo ditë të lume. Lajmet e ngjashme as që ka nevojë që të na vijnë nga të parët e shtetit tonë. Këta tanët votën e kanë marrë për të bërë punë të mira për qytetarët dhe për të forcuar çdo segment të shtetit të pavarur, sovran e demokratik. Nuk janë aty për t'u bërë zëdhënës të politikës së Beogradit. Se çka do Beogradi për ne shqiptarët e dimë mirë që më shumë se një shekull. Ato politika secilit që do, që di, sheh e dëgjon, i ka përjetuar në kurrizin e vet.

Krerët e institucioneve tona, janë aty për t'i mbrojtur e mbrojtur fortë interesat e qytetarëve të Kosovës, për të krijuar e hapur perspektiva të reja, për të organizuar mirë e fortë sektorin e sigurisë kombëtare edhe nga konfliktet apo luftërat e reja. Nëse është rreziku i ndonjë konflikti të armatosur që rrezikon sigurinë kombëtare, ata duhet ta përgatisin kombin për t'i marrë të gjitha masat e duhura. Për këtë pozicioni ynë është shumë më i mirë sesa ishte në vitet 1997-'98 e '99. Ju që dhjetë vite keni qenë në pozita për t'i garantuar jo vetëm këto që u cekën, por është shumëçka tjetër, është mirë t'i tregoni kombit se jeni të paafte për të drejtuar shtetin dhe për të qeverisur në të mirë të vendit e kombit.

Ju, nëse nuk e dini mësoni, normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë as nuk është varur e as nuk varet nga ne. Ne, as luftën nuk e kemi bërë me qejf, por pse na është imponuar. Për t'i normalizuar marrëdhëniet kemi bërë kompromise pas kompromisi, Serbia asnjë herë nuk ka qenë e gatshme për normalizim të marrëdhënieve, ajo nuk është as sot. Ketë e deklarojnë çdo ditë krerët e shtetit serb, që edhe në kohën e gjenocidit serb, kanë pasur pozita të larta në Serbi.

Serbia do t'i normalizonte marrëdhëniet me Kosovën, por pa shqiptarët. Pra Serbia është në politikat e saja të njohura.

Kështu mos u lodhni kotë, por kujdesuni për ta ndërtuar shtetin e së drejtës, shtet që do të garantonte perspektivën e qytetarëve të vet. Këtë keni për obligim që ta bëni. Mos u bëni merak se çka do e nuk do Serbia.



Studentët e Infermierisë të AAB-së firmosin kontrata për punë në tregun gjerman

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINE, 12 TETOR - Marrëveshja e bashkëpunimit, e nënshkruar muaj më parë nga Kolegji AAB me kompanitë partnere gjermane, tashmë ka gjetur zbatim edhe në praktikë. Me një ceremoni solemne të premtën studentët e Fakultetit të Infermierisë të Kolegjit AAB nënshkruan kontratat e para të punës me partnerët gjermanë DKV "Pflegerdienste und Residenzen GmbH", respektivisht "miCura Pflegerdienste und Residenzen GmbH".

Në hapje të ceremonisë zëvendësrektorit, prof. dr. Shemsedin Vehapi, ka thënë se konkretizimi i nënshkrimit të këtyre 18 kontratave ka rëndësi të veçantë jo vetëm për Kolegjin AAB dhe studentët, por edhe për arsimin në Kosovën në përgjithësi. Ndërsa përfaqësuesja e kom-

panisë DKV Pflegerdienste und Residenzen GmbH, Elke Bruggemann, ka shtuar se Gjermania ka nevojë për studentë të tillë që të kontribuojnë në fushën e mjekësisë atje. Ajo ka bërë me dije për studentët se kanë krijuar edhe dy kurse të reja që studentët do të kenë mundësi të bëhen pjesë e tyre në muajt në vazhdim. "Të dashur studentë dhe ju pjesëmarrës, ne kemi nevojë pikërisht për këtë që po ndodh sot, por më lejoni t'ju kumtoj një lajm të ri: dje ne ia dolëm të krijojmë edhe dy kurse të reja të gjuhës, një kurse sa i përket përkujdesjes shtëpiake dhe një kurs për klinikë. Emrat dhe fillimi i kursit të gjuhës do të kumtohen së shpejti. Për ne është e rëndësishme sepse kompanitë tona kërkojnë studentë të aftë që pastaj edhe do të angazhohen në Gjermani", ka deklaruar Bruggemann.

Gjatë kësaj ceremonie të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit

nga Bayerni, Benjamin Schaffirna dhe Michael Stier, të cilët thanë se janë ndarë jashtëzakonisht të kënaqur me studentët e Kolegjit AAB. Sipas tyre, guximi dhe motivimi që studentët e infermierisë kanë treguar gjatë këtyre ditëve, i ka shtyrë ata që bashkëpunimi me Kolegjin AAB të mos mbetet vetëm me nënshkrimin e këtyre kontratave.

Studentët e përzgjedhur që kanë nënshkruar kontratat e para të punës, punën e tyre do ta zhvillojnë në: Berlin, Dusseldorf, Hamburg, Munchen dhe Nurnberg.

Ndërkohë, Programi i Karrierës dhe Punësimit, i themeluar si rezultat i marrëveshjes për bashkëpunim në mes të Kolegjit AAB dhe partnerëve gjermanë DKV "Pflegerdienste und Residenzen GmbH", do të vazhdojë edhe më tej për të rekrutuar studentë të rinj të cilët janë të kërkuar në tregun gjerman të punës.

Tahiri: "Drejtësia 2020", mundësi për ta kthyer besimin e qytetarëve në institucionet e drejtësisë

PRISHTINE, 12 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të premtën në një takim të përbashkët ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi, si dhe ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu. Në takim ministri Tahiri ka njoftuar ambasadorët për punën që është bërë në përmirësimin e legjislacionit, si dhe për reformat e tjera të ndërmarra, rishikimin funksional të sek-

torit të sundimit të ligjit dhe agjendën e përbashkët me Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial "Drejtësia 2020".

Ministri Tahiri ka deklaruar se kohët e vështira për funksionimin e sektorit të drejtësisë po tejkalohen dhe se nuk duhet të humbet mundësia që gjyqësori në Kosovë të jetë i besueshëm për të gjithë qytetarët. Ndërsa ambasadorët kanë dhënë mbështetjen e tyre për "Drejtësia 2020", duke theksuar

se kjo agjendë tregon përkushtimin e fuqishëm që kanë institucionet vendore, përtej obligimeve legjislative, për zgjidhjen e shumë problemeve me mirëbesim. Gjatë takimit, ministri dhe ambasadorët biseduan edhe për organizimin e punëtorisë me karakter trajnues për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe Policinë e Kosovë në luftën kundër korrupsionit që do të mbahet javën e ardhshme në Prishtinë.





Komisionarja e BE-së: Kosova ka plotësuar kriteret për liberalizim të vizave

"Kosova ka punuar shumë për ta fituar liberalizimin e vizave dhe mund t'ju urojmë për të gjitha këto. Është e rëndësishme të vazhdohet dialogu me të gjitha shtetet që të merret vendimi sa më shpejt. Të gjitha kriteret janë plotësuar, por nuk është proces i lehtë", ka thënë të premtën në Prishtinë komisionarja e Bashkimit Evropian për Ekonomi dhe Shoqëri Digjitale, Mariya Gabriel

që të merret vendimi sa më shpejt. Të gjitha kriteret janë plotësuar, por nuk është proces i lehtë. E keni këtë potencial dhe është e rëndësishme që të vazhdoni. Liberalizimi i vizave është i rëndësishëm për ju dhe vazhdoni të punoni brenda vendit tuaj", ka thënë Gabriel në një konferencë për media pas takimit me zëvendëskryeminstriin e Kosovës, Enver Hoxhaj. Gabriel ka folur edhe për partneritetin rreth teknologjisë si një motor të zhvillimit të ekonomisë.

Zëvendëskryeminstri Hoxhaj ka falënderuar komisionaren Gabriel për vizitën dhe mbështetjen e saj dhënë Kosovës ndër vite. Hoxhaj ka

theksuar se Kosova ka potencial të madh për inovacion, duke filluar nga popullsia e re në moshë, interesimi i shoqërisë civile, e deri tek investimet e Qeverisë së Kosovës në këtë fushë.

Zëvendëskryeminstri Hoxhaj ka thënë se është shumë i rëndësishëm lansimi i agjendës digjitale për Ballkanin Perëndimor nga ana e Komisionit Evropian, e në veçanti foli për rëndësinë e uljes së tarifave të roamingut për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ndërsa zëvendëskryeminstri Hoxhaj ka pohuar se Qeveria e Kosovës është më se e interesuar të investojë edhe më shumë në nxitjen e zhvillimit

ekonomik nëpërmjet inovacionit, mirëpo theksoi se regjimi i vizave për Kosovën ka kufizuar mundësitë e të rinjve kosovarë dhe ndërmarrësve që të kenë qasje në të rejtat më të fundit, në mënyrë të barabartë me qytetarët e tjerë të gjithë Evropës. "Prandaj, inovacioni më i madh që mund t'i sjellë BE-ja Kosovës tani, është liberalizimi i vizave. Ne mund të jemi vend i vogël për nga territori, vend i vogël për nga popullsia, dhe në kuptimin e ekonomisë sonë e cila është në zhvillim e sipër, mirëpo ajo se çfarë ka parë dje komisionarja Gabriel, në vizitat e saj, tregon më së miri potencialin që ka vendi ynë", ka thënë zëvendëskryeminstri Hoxhaj.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 TETOR - Komisionarja e Bashkimit Evropian për Ekonomi dhe Shoqëri Digjitale, Mariya Gabriel, ka bërë me dije të

premtën në Prishtinë, se Kosova ka plotësuar kriteret për liberalizim të vizave. "Kosova ka punuar shumë për ta fituar liberalizimin e vizave dhe mund t'ju urojmë për të gjitha këto. Është e rëndësishme të vazhdohet dialogu me të gjitha shtetet

Bosnja nuk mund ta ndryshojë qëndrimin sa i përket njohjes së Kosovës

PRISHTINË, 12 TETOR - I sapozgjedhuri në presidencën trepalëshe të Bosnje Hercegovinës, Sefik Xhaferović nga Partia për Aksion Demokratik, ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", se pa pasur një konsensus të të gjithë anëtarëve të presidencës, Bosnja nuk mund të ndryshojë qëndrimin sa i përket njohjes së Kosovës. "Bosnje dhe Hercegovina e ka qëndrimin zyrtar kur është në pyetje kjo çështje, i cili thotë se për çfarëdo vendimi është i nevojshëm konsensusi i të gjithë anëtarëve të Presidencës, dhe këtë konsen-

sus në këtë moment nuk e kemi dhe kështu do të jetë derisa nuk ndryshojnë gjërat", ka thënë Xhaferović.

Megjithatë, Xhaferović, kandidati që mori më së shumti vota në zgjedhjet e fundit në Bosnje, ka thënë se Kosova dhe Bosnja duhet ta kenë nivelin e bashkëpunimit të paktën siç e ka sot Serbia me Kosovën. "Mendoj se Bosnje dhe Hercegovina dhe Kosova duhet të kenë nivelin e bashkëpunimit, të paktën siç e ka sot Republika e Serbisë me Kosovën. Sepse ne me Kosovën jemi në nivel më të ulët



bashkëpunimi sesa që është Serbia. Më shumë ka liri të lëvizjes së mallrave, kapitalit dhe njerëzve në mes të Kosovës dhe Serbisë sesa mes Kosovës dhe Bosnjës, kjo për shkak se nuk

ekziston gatishmëria nga ana e politikanëve të Republikës serbe që kjo situatë të përmirësohet. Mendoj se këto raporte duhet të ndërtohen në mes të Bosnjës dhe Kosovës në interes të të dy

vendeve, edhe përkundër qëndrimin politik kur është fjala për njohjen e Kosovës", ka thënë Xhaferović për Shërbimin e Ballkanit të "Radios Evropa e Lirë".

Në zgjedhjet e 7 tetorit në Bosnje, përveç kandidatit boshnjak Sefik Xhaferović, një vend në presidencën trepalëshe e ka fituar edhe nacionalisti nga Republika Serbe Millorad Dodik, i cili njihet për raporte të afërta me Rusinë. Anëtarë i tretë është zgjedhur social-demokrati Zheljko Komshiq, që ka shërbyer dy mandate në presidencë.

Kosova merr mbështetje nga drejtues të lartë të FMN-së dhe Bankës Botërore

BALI, 12 TETOR (ER) - Në ditën e tretë të takimeve vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore që po mbahet në Bali të Indonezisë, delegacioni i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga guvernatori Fehmi Mehmeti, ka marrë pjesë në sesionin plenar të FMN-së dhe BB-së, ku fjalimet kryesore u mbajtën nga presidenti i Indonezisë, shkëlqesia e tij Joko Widodo, drejtoresha menaxhuese e FMN-së, Christine Lagarde dhe presidenti i Bankës Botërore, Jim Yong Kim. Delegacioni i Kosovës ka takuar edhe zëvendëspresidentin e Bankës Botërore, Cyril

Muller dhe drejtoreshën e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Linda Van Gelder. Gjithashtu, janë zhvilluar takime me drejtorin e ri të Konstituencës tonë në FMN, Raci Kaya, si dhe me drejtorin në ardhje të Konstituencës sonë në Bankën Botërore, Guenther Schoenleitner. Në kuadër të takimeve vjetore në Bali të Indonezisë, delegacioni i BQK-së ka marrë pjesë në takimin hapës të Komitetit Ndërkombëtar Monetar dhe Financiar të FMN-së, si dhe në takimet e ndara të Konstituencës së Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, pjesë e të cilave është edhe Kosova.



ATK-ja grumbullon 336 milionë euro të hyra për periudhën janar-shtator

PRISHTINË, 12 TETOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) përmes një komunikate për medie ka bërë me dije se po vazhdon performancën në bazë të zotimeve të cilat i ka përcaktuar për këtë vit dhe në përputhje me projeksionet e përcaktuar nga ana e Qeverisë së Kosovës. Deri më 30 shtator të këtij viti ATK-ja ka grumbulluar 75.5 për qind të të hyrave të përgjithshme vjetore që, shprehur në shifra, janë 336.6 milionë euro. "Se kemi një nivel shumë të mirë sa i përket realizimit të planit të të hyrave këtë e tregon edhe krahasimi në mes të periudhave nëse e krahasojmë periudhën janar-shtator 2018 me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi rritje për 32.8 milionë euro, ndërsa më shumë se plani kemi 9.6 milionë euro apo 2.9 %", është theksuar në komunikatë.


Sipas ATK-së, rezultat për rritjen e të hyrave është avancimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve të cilat kanë lehtësuar në masë të madhe deklarimin dhe pagesën e tatimeve si dhe kanë ngritur nivelin e përmbushjes vull-

netare. Po ashtu, rol të rëndësishëm ka edhe pjesa e legjislacionit tatimor përmes së cilës bëhen përpjekje të vazhdueshme që të krijohet një infrastrukturë e mirë ligjore. "Me kry-

erjen e detyrimeve tatimore, kontribuoni drejtpërdrejt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimimi me standarde të larta, mirëqenia shëndetësore

dhe sociale, mbrojtja ligjore dhe siguria, si dhe infrastruktura e përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore. Motoja e përgjithshme e punës sonë vazh-

don të qëndrojë për krijimin e një mjedisi, i cili mbështet fuqimisht përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve", është thënë më tutje në komunikatën e ATK-së.



Ministri Reçica merr përkrahjen e Gjermanisë

PRISHTINË, 12 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, i shoqëruar nga shefi i misionit diplomatik të Kosovës në Stuttgart të Gjermanisë, Blerim Canaj, ka takuar ministren e shtetit të Landit të Baden

Württembergut, Theresa Schopper. "E falënderova znj. Schopper për mbështetjen që Gjermania po i jep Kosovës, sidomos rreth përfshirjes së të rinjve nga Kosova përmes edukimit të kuadrove në profesionet që kërkon tregu i punës në Kosovë

dhe Bashkim Evropian. Ministrja Schopper konfirmoi gatishmërinë për ta zgjeruar bashkëpunimin me Kosovën jo vetëm në rrafshin socio-ekonomik, por edhe në planin politik, duke mbështetur rrugëtimin e Kosovës drejt BE-së", ka thënë Reçica.



Institucionet e vendit premtojnë se do ta rrisin mbështetjen për të rinjtë novatorë



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se teknologjia informative sot është parametri themelor që përcakton nivelin e zhvillimit ekonomik të një vendi. "Ne duhet të jemi të përgatitur që t'i kapim ritmet e zhvillimeve që po ndodhin në këtë sektor", është shprehur Veseli në konferencën ndërkombëtare "Digitalks"

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka marrë pjesë në konferencën ndërkombëtare "Digitalks" që po mbahet në Prishtinë, ku i ka dhënë mbështetje të plotë sektorit të inovacionit dhe ndërmarrësisë që, sipas Veselit, po e zhvillon dhe do të krijojë shumë mundësi të reja për rininë inovatore të Kosovës. "Teknologjia informative sot është parametri themelor që përcakton nivelin e zhvillimit ekonomik të një vendi dhe ne duhet të jemi të përgatitur që t'i kapim ritmet e zhvillimeve që po ndodhin në këtë sektor. Ne kemi popullatën më të re në Evropë por, ky fakt, nuk nënkupton vetvetiu zhvillim. Duhet ta aftësojmë, ta përgatisim këtë popullatë të re, për

të qenë pjesë aktive e trendëve bashkëkohorë të zhvillimit ekonomik. Ky ka qenë qëllimi pse kemi vendosur ta krijojmë Ministrinë e Inovacionit, në mënyrë që të gjitha idetë dhe projektet inovative të të rinjve të Kosovës të mbështeten praktikisht. Rëndësia e kësaj mbështetjeje është e shumëfishtë: krijohet besimi se idetë e tyre të rinjtë e Kosovës mund t'i realizojnë në vendin e tyre. Kjo sjell natyrisht vende të reja të punës dhe bashkë me vendet e punës edhe mentalitetin se të rinjtë tanë nuk duhet të jenë vetëm punëkërkuar, por edhe punëkrijues", ka thënë Veseli. Kreu i Kuvendit, i cili ishte edhe iniciator i themelimit të Ministrisë Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, tha se do të vazhdojë ta mbështesë çdo iniciativë për mbështetjen e të rinjve inovatorë që ka Kosova

sepse, siç tha ai, këta të rinj do të jenë e ardhshmeja që garanton forcim të shtetit dhe zhvillim ekonomik. "Sot jam këtu për t'ju dhënë gjithë përkrahjen time. Do të rriten edhe më shumë fondet e Ministrisë që shkojnë në përkrahje të ideve dhe projekteve inovative. Sot vendi ynë ka nevojë që jo vetëm njerëzit, por edhe idetë e tyre ekonomike të qëndrojnë këtu dhe të bëhen faktorë në zhvillimin ekonomik. Tani që kemi përfunduar autostradat infrastrukturore, është koha të lëvizim në drejtim të krijimit të autostradës digjitale të Kosovës. Si në rastin e parë, edhe në të dytin, ne kemi gjithë potencialin të jemi më të mirët në rajon", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Kurse ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka deklaruar se synojnë që kjo konferencë të bëhet vjetore. "Digitalks synon të jetë konferencë vjetore që mbledh 1 000 palë të interesuara, politikëbërës, akademikë, studentë, inovatorë dhe shtesa ndërmarrëse që synon t'i shkëmbejë praktikën me të mira për nxitjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë dhe rritjen ekonomike të qëndrueshme që bën prosperitet për rininë tonë", është shprehur Beqaj.

Zhvillimi i rajonit, sipas tij, mundësohet përmes gjeneratave të reja. "Ne besojmë se integrimi evropian duhet të shkojë përmes reformave ekonomike dhe përgatitjes së zhvillimit ekonomik. Kemi sfida dhe nevoja për ta ndryshuar konceptin ekonomik dhe na mundëson që rajoni të shkojë drejt zhvillimit dhe kjo është e mundur përmes gjeneratave të reja që po shkon më shpejt sesa institucionet tona", është shprehur Beqaj. Sipas Beqajt, teknologjia digjitale po rritet shtatë herë më shumë sesa pjesa tjetër e ekonomisë. "Teknologjia digjitale po rritet shtatë herë më shumë se pjesa tjetër e ekonomisë. Rajoni ka nevojë që rininë e trajnuar dhe të edukuar ta mbajë në vendet tona dhe të punojë për tregjet evropiane. Ne synojmë rininë ta mbajmë në Kosovë, të punojë në rajon dhe tregje evropiane", ka deklaruar ai. Beqaj ka pohuar se Kosova është e interesuar që përmes zhvillimit të ndërmarrësisë dhe inovacionit të zhvillojë ndërmarrje të vogla dhe mesme. "Inovacioni dhe teknologjia janë të domosdoshme për të pasur zhvillim të qëndrueshëm, për të përmirësuar procese, për

ta rritur konkurrencën, për të ofruar zgjidhje kreative dhe kërkon burime të kualifikuara njerëzore dhe kjo është pse duhet ta lidhim ekonominë me edukimin", është shprehur Beqaj. Mariya Gabriel, komisionarja e BE-së për Ekonomi dhe Shoqëri Digjitale, ka deklaruar se ngjarjet e tilla ku mbledhen të gjitha vendet e Ballkanit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Sipas saj, BE-ja dhe kjo pjesë e Ballkanit kanë të ardhme të përbashkët, prandaj ajo ka shtuar se duhet angazhimi i të gjithë në këtë drejtim. "Ngjarjet e tilla mbledhin personalitete dhe profesionist nga të gjitha shtetet e Ballkanit për t'i shkëmbyer njohuritë e tyre dhe praktikën duke kontribuar drejt promovimit të ndërmarrësisë duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rritje ekonomike në Kosovë dhe regjion. Kjo është bërthama e vizionit tonë si Komision Evropian. Ne jemi të bindur se puna e përbashkët me partneritet mund t'u ofrojë qytetarëve mundësi më të mirë dhe perspektivë konkrete evropiane", ka thënë ajo, duke shtuar se BE-ja dhe Ballkani Perëndimor kanë të ardhme të përbashkët si kultura, historia, dhe vlerat.

Ambasadorët e Francës në Prishtinë dhe Beograd vizituan Mitrovicën

MITROVICË, 12 TETOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka pritur në një takim ambasadorin e Republikës së Francës në Prishtinë, Dider Chabert dhe ambasadorin e Francës në Beograd, Frederik Mondoloni, me të cilët ka biseduar për situatën e përgjithshme dhe zhvillimet aktuale në Mitrovicë. Ambasadori i Republikës së Francës në Prishtinë, Didier Chabert, pasi e ka falënderuar nënkryetarin Mujka për mikpritje, ka thënë se është i lumtur që sërish gjendet në Mitrovicë për t'i konfirmuar raportet e mira të

ndërsjella ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Ambasadës së Francës në Prishtinë. "Sot në Mitrovicë gjendem bashkë me ambasadorin e Republikës së Francës në Beograd, i cili ka ardhur në një vizitë studimore, andaj edhe gjatë ditës kemi takuar drejtorët e Komunës së Mitrovicës Veriore, pastaj edhe drejtuesit e Kombinatit 'Trepça' në jug dhe veri, ndërsa që tani kemi kënaqësinë që gjendemi në Komunën e Mitrovicës Jugore, për t'u informuar drejtpërdrejt dhe nga afër për situatën dhe zhvillimet aktuale këtu", ka thënë ai.



Komuna e Hanit të Elezit ndërpret punimet e Bechtel-Enkas

HANI I ELEZIT, 12 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka marrë vendim për ndërprerjen e bashkëpunimit me kompaninë Bechtel-Enka e cila po ndërton autostradën Prishtinë - Shkup. "Për shkak të dëmtimit të pronës publike dhe private, mbylljes së disa rrugëve ekzistuese dhe zhurmës së madhe gjatë natës nga ana e kompanisë Bechtel-Enka e cila po realizon projektin e autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit ka vendosur ta ndërpresë komunikimin dhe bashkëpunimin me kompaninë Bechtel-Enka", është bërë me dije në njoftimin e

Komunës së Hanit të Elezit. Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, pas disa paralajmërimeve dhe kërkesave drejtuar kompanisë Bechtel-Enka për riparimin e dëmeve, rihapjen e rrugëve të mbyllura, ndotjen dhe degradimin e ambientit, i është drejtuar me një letër drejtorit gjeneral të kompanisë Bechtel-Enka, Riadh Alkhazraji, të cilin e ka njoftuar me vendimin për ndërprerjen e bashkëpunimit të mëtuftëshëm dhe për riparimin e dëmeve të shkaktuara. "Po të njëjtën ditë, më 11.10.2018, në orët e vona të natës, pas orës 23:00, kryetari Suma, i shoqëruar nga drejtori i

Shërbimeve Publike, Refet Kalisi, dolën në vendpunishte të autostradës në territorin e Komunës së Hanit të Elezit dhe ndërprejnë punimet e kompanisë Bechtel Enka për shkak të punimeve që bëheshin në orët e vona të natës me çka pengohej jeta normale e qytetarëve nga zhurma që krijohej. Përderisa kompania Bechtel Enka nuk do t'i riparojë të gjitha dëmet e shkaktuara në pronat publike komunale dhe ato private të pa, Komuna e Hanit të Elezit nuk do të lejojë këtë kompani ta shfrytëzojë pronën publike komunale", është thënë në njoftimin e komunës.



Filluan punimet për ndërtimin e rrjetit të ujërave të zeza në fshatin Tërpezë

MALISHEVË, 12 TETOR (ER) - Komuna e Malishevës po hyn në fazën finale të realizimit të projekteve të planifikuara për vitin 2018, rregullimi i infrastrukturës në shtrimin e rrugëve me asfalt, rregullimi i trotuareve dhe ujësjellësit e rrjeteve të ujërave të zeza. Të premtën kanë filluar punimet për rregullimin dhe funksionalizimin e dy kilome-

trave kanalizim që do të shërbejnë për banorët e fshatit Tërpezë, projekt kryesisht që financohet nga Komuna e Malishevës. "Kështu dinamika e realizimit të projekteve për këtë vit po ecën sipas planit të qeverisë lokale, ku ashtu si janë planifikuar, edhe po realizohen, duke iu përmbajtur rreptësisht cilësisë dhe standardeve të nënshkruara në kon-

tratë, në mes të punëdhënësit dhe punëkryesit, në të kundërtën mund të shqiptohen sanksione buxhetore, për jo cilësi të punës dhe mosrealizim të projektit në afatin e paraparë kohorë. Investimet komunale do të vazhdojnë për këtë vit ashtu si janë planifikuar", është bërë me dije në komunikatën e Komunës së Malishevës.


Aktakuzë për vrasje në tentativë dhe armëmbajtje pa leje

PRISHTINË, 12 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurve E. I. dhe V. I. Prokuroria njofton se në muajin shtator 2018, në Komunën e Gjilanit, i pandehuri E. I., me veprim të drejtpërdrejtë dhe me dashje ka tentuar ta privojë nga jeta të dëmtuarin E. Z., në atë mënyrë që i përgatitur me armë dhe sëpatë shkon te shtëpia e të dëmtuarit dhe derisa tenton të shkrepë me armë në drejtim të tij, aty ndërhyjnë i pandehuri V. I., i cili e pengon këtë veprim, me ç'rast arma shkrepë para këmbëve të të pandehurit.

Me këto veprime i pandehuri E. I. ka kryer veprën penale "Vrasje në tentativë", nga neni 178, lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, i pandehuri E. I. pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët ka mbajtur në pronësi armë zjarri dhe pesë (5) fishekë, me ç'rast ka

kryer edhe veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

Ndërsa i pandehuri V. I., pas rastit të ndodhur, ka mbajtur në posedim të njëjtën armë në shtëpinë e vet, me çka ka kryer veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 374, paragrafi 1 i KPRK-së. Po ashtu, në aktakuzë i është propozuar gjykatës, që të pandehurit E. I. t'i shqiptojë dënim plotësues - konfiskimin e armës dhe të njëjtit t'i vazhdohet masa e arrestit shtëpiak.



'Mos të kemi frikë të negociojmë, por jo të negociojmë pa pasur frikë'

(J. F. Kennedy)



Prof. Lisen BASHKURTI

Negociatat janë instrumenti më efikas i diplomacisë. Në vetvete negociatat janë një proces i pafund. Negociatat janë një lëvizje e pandërprerë në veprimtarinë diplomatike. Negociatat janë vetë mënyra e ekzistencës së diplomacisë. Kur ndërpritën negociatat, diplomacia hesht. Kur hesht diplomacia, flet forca. Edhe dialogu midis Kosovës dhe Serbisë është i tillë.

Kenedi ka qenë një nga presidentët më diplomat në historinë e Shtetësisë së Bardhë. Ai na ka lënë mendimin... mos të kemi frikë të negociojmë, por jo të negociojmë pa pasur frikë... Ky mendim filozofik është një mesazh shumë i thellë për thelbin e negociatave, për rëndësinë e tyre, për vështirësinë dhe sfidat që ato kanë. Negociatat janë si gjithë betejat e tjera, veçse me mjete paqësore. Negociatat prodhojnë tre lloje rezultatesh. Ato mund të sjellin fitore për njërin palë dhe humbje për palën tjetër; ato mund të prodhojnë fitore pa të humbur për asnjërin palë, pra zgjidhje kompromisi; ato mund ta sjellin humbjen e të dy palëve, pra dështimin e tyre.

Nga këto tre lloje rezultatesh që prodhojnë, negociatat diktojnë edhe qasjet ndaj tyre. Ato janë mundësia më e mirë, më e lirë, më e dobishme, më e drejtë, më e qëndrueshme dhe më e zbatueshme për zgjidhjen e problemeve të çdo natyre. Mundësia për zgjidhje kompromisi, ose zgjidhje pa të humbur është inspiruese dhe inkurajuese në vetvete. Si të tilla negociatat na bëjnë që të mos kemi frikë që të negociojmë...

Por, negociatat mund të prodhojnë edhe dështim të rëndë për njërin palë, ose dështim fatal për të dy palët njëkohësisht. Dështimi i negociatave është e keqja më e madhe. Më mirë mos të hyhet në negociata sesa të dështohet në to. Dështimi vret shpresën dhe besimin të palët negociuese se mund të arrijnë në zgjidhje diplomatike kompromisi midis tyre. Besimi i thyer nga dështimi i negociatave është gati-gati si buka e thyer. Pas dështimit të negociatave ose rickulohen rrugë e mjete të tjera jo diplomatike e jo paqësore, ose do të duhet shumë kohë që të mundri-fillojnë sërish negociatat. Kosto është e lartë në të dy variantet. Kjo është arsyeja që nuk mund të negociojmë pa pasur frikë... Kosova është në një fazë delikate të

historisë së saj politike. Në këtë fazë diplomacia është në plan të parë. E brenda saj diplomacie aftësia negociuese është në krye të të gjithave. Nga dikush kjo është quajtur si "faza e fundit e dialogut". Nuk më është dukur përcaktim racional. Teorikisht është e pasaktë, ndërkohë që praktikisht është i nxituar. Ajo që mund të themi është fakti që dialogu Kosovë-Serbi ka hyrë në një fazë të re, e cila synon të krijojë një marrëveshje kuadër të gjerë që do t'i hapte rrugë radialisht normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve.

Kjo fazë e re duket të jetë e gjatë, e komplikuar dhe shumë e vështirë. Janë shumë variabla që ndikojnë për këtë. Variabla të paqëndrueshme brenda Kosovës, variabla kontradiktore brenda Serbisë, variabla ambigje brenda Ballkanit, variabla dinamike brenda BE-së, variabla kaotike gjeopolitike euro-aziatike dhe variabla transitive ndërkombëtare. Siç shihet jemi në një fazë ku lypet të konsiderohen faktorë, aktorë dhe dukuri të shumta të paqëndrueshme, kontradiktore, ambigje, dinamike, kaotike dhe tranzitive mjaft të paparashikueshme. Për këtë arsye përcaktimet "faza e fundit e dialogut" apo "faza e normalizimit" të marrëdhënieve janë shumë të diskutueshme dhe më shumë reflektojnë qëndrime subjektive plot keqkuptime sesa reflektojnë realitetet aktuale dhe perspektive. Gjithë këto variabla janë në tryezën e negociatave Kosovë-Serbi. A është përgatitur diplomacia e Kosovës për t'u përballur me to? A është e qartë diplomacia e Kosovës në qëllimin dhe objektivat e saj? A ka vendosur prioritetet e veta diplomacia e Kosovës? A ka parashikuar diplomacia e Kosovës gjithë opsionet e mundshme? A ka marrë parasysh diplomacia e Kosovës tërë skenarët që mund të sjellin negociatat? A ka përllogaritur diplomacia e Kosovës avantazhet dhe dizavantazhet e saj? A e njeh mirë diplomacia e Kosovës strategjinë e diplomacisë Serbe? A e njeh diplomacia e Kosovës mirë vetveten, fuqinë dhe aftësinë e saj? A e njeh diplomacia e Kosovës sa dhe siç duhet lëndën për të cilën do negociohet? A i ka studiuar diplomacia e Kosovës faktorët e brendshëm, faktorët Rajonal, Evropian dhe botëror? Së fundi a ka përgjigje për të gjitha këto pyetje në dosjen e vet diplomacia e Kosovës?

Referuar Kenedit, mund të thuhet se Kosova nuk ka frikë për të hyrë në bisedime. Por shqetësues është fakti që Kosova duket se hyn në negociata pa pasur frikë. E mungesa e frikës vjen nga mos njohja e negociatave, nga përgatitja e pamjaftueshme për t'u përballur me to, nga moslllogaritja e rezultateve dhe pasojave të mundshme, nga

mosparashikimi i konsekuencave që mund të sjellin ato. Në thelb hyrja në negociata pa pasur frikë është naivitet diplomatik, është mungesë përgatitje, përgjegjësie dhe profesionaliteti. Më duket se diplomacia e Kosovës është në këtë gjendje. Por, situata nuk është pa shpresë dhe pa rrugëdalje.

Për të kapërcyer këtë gjendje naive lidhur me negociatat Kosova lypet të ketë parasysh disa elementë: Së pari, është përpilimi i strategjisë së negociimit, pra heqja dorë nga improvizimet apo të ashtuquajtura projekte kulisash. Strategjia e negociimit ka të bëjë me hartimin e tërësisë së politikave, me anën e të cilave synohet të arrihen qëllimi kryesor i negociimit dhe objektivat kryesore. Në strategji përfshihen edhe prioritetet themelore të renditura për nga shkalla e rëndësisë. Prioritetet shoqërohen me gjithë opsionalitetin e mundshëm. Më tej përpilohen skenarët përkatëse që përmbajnë pritshmërinë me avantazhet dhe disavantazhet, me përfitimet dhe humbjet, me shkallën e garancisë dhe të rrezikshmërisë.

Dokumenti strategjik i negociimit përcakton edhe vijat e kuqe përtej të cilave nuk negociohet; vijat fleksibile, të cilat janë tit-for-tat për tërheqje dhe lëshime; si dhe vijat gri, të cilat në rrethana ultimative mund të jenë pjesë e lëshimeve. Së fundi dokumenti strategjik do duhet të përpilojë tre skenarët prognozë të përfundimit të negociatave: skenarin e arritjes së kompromisit; skenarin e humbjes të njëanshme; dhe skenarin e dështimit dypalësh të negociatave. Dokumenti strategjik do të ofrojë rrugëdaljet që do të duhet të ndjekë Kosova pas këtyre tre skenarëve.

Dokumenti strategjik i negociimit përgatitet nga tërësia e institucioneve kushtetuese të Kosovës të ngarkuar për politikë bërje dhe vendimmarrje në politikën e jashtme. Themeli ligjor është kuadri kushtetues i Kosovës. Asnjë individ dhe asnjë institucion i veçantë nuk mund të anashkalojë kushtetutën në këtë dokument strategjik negociimi. Anashkalimi i kushtetutës është tradhti historike. Sikundër asnjë individ dhe asnjë institucion i veçantë nuk mund të anashkalojë gjithëpërfshirjen ndërinstitucionale në përpilimin e strategjisë së negociimit. Çdo lëvizje dhe iniciativë jashtë institucionale shpie gjithashtu në gabime me pasojë historike.

Së dyti, pas përpilimit të këtij dokumenti strategjik negociues gjithëpërfshirës ndërinstitucional kalohet në miratimin e ekipit negociator dhe udhëheqësit të tij. Ekipi negociator është institucion ad-hoc i krijuar enkas për realizimin e dokumentit strategjik negociues. Ky ekip nevojitet të jetë atdhetar që jep garanci; të jetë

gjithëpërfshirës, që shpreh angazhim e kontribut; të jetë me integritet të lartë, që krijon besim; të jetë me kulturë e profesionalitet, që ushqen shpresë; të jetë me eksperiencë, që ofron modele suksesi. A ka Kosova kapacitete të tilla? Mendoj se ka plot. A po i konsideron klasa politike e Kosovës kapacitetet e vendit? Mendoj se jo. Kosova ka mjaft kapacitete njerëzore, këto duhen angazhuar në procesin e negociatave, por kjo nuk do thotë se s'mund të angazhohen edhe ekspertë jashtë Kosove.

Së treti, ekipi negociator ka shumë punë përgatitore për të bërë. Ai është hartuesi i taktikave të negociimit në proces e sipër. Ekipi ndan rolet e anëtarëve në përputhje me taktikën e negociimit dhe në dinamikë e sipër. Përcakton gjuhën verbale të negociimit. Gjithashtu përcakton gjuhë trupore e xhestikulare. Ekipi përpilon taktikat e punës me grupe të ndryshme ekspertësh, harmonizohet me faktorët jashtë negociatorë, komunikon me opinionin publik dhe median. Është ky ekip që hap pas hapi ofron raporte të detajuara mbi ecurinë e procesit të negociimit në përputhje me dokumentin strategjik negociues. Së katërti, në krye të ekipit negociator vihet një personalitet me vlera, besim, kulturë dhe aftësi të njohura në fushën diplomatike në përgjithësi dhe të negociatave në veçanti. Kredibiliteti politik, profesionaliteti diplomatik dhe respekti ndërkombëtar janë trinomi i vlerave të kërkuara për liderin e ekipit negociator. Negociatat duhet t'i udhëheqë një njeri, por ato nuk mund të bëhen kurrsesi pa një punë përgatitore në ekip, pa ecuri negociatash në ekip, pa konsultim në proces në ekip dhe pa vendimmarrje në ekip.

Në procesin e negociatave Kosovë-Serbi ka rëndësi edhe përcaktimi i aleatëve strategjikë ndërkombëtar mbështetës, ndërmjetësues dhe garantues. Përcaktimi i aleatëve strategjikë ndërkombëtar mbështetës, ndërmjetësues dhe garantues nuk mënjanon përgjegjësitë kryesore të Shtetit të Kosovës. Përpjekja për të ndarë përgjegjësi me aleate strategjike është kryekëput e gabuar. Presidenti, Qeveria dhe gjithë institucionet kushtetuese politikëbërëse dhe vendimmarrëse të politikës së jashtme të Kosovës lypet të bëjnë punën e tyre paraprake, përgatitjet respektive, të demonstrojnë legjitimitet, transparencë, përgjegjshmëri dhe gjithëpërfshirje. Mbas kësaj mund të kërkojnë partnerë strategjikë ndërkombëtarë mbështetës, ndërmjetësues dhe garantues, duke përfshirë ShBA, BE apo shtete individuale të veçanta. Këto të fundit mbeten faktorë të huaj mbështetës, ndërmjetësues apo garantues. Baza

ngelen institucionet sovraane e legjitime kushtetuese të Republikës së Kosovës. Pra, dokumenti strategjik negociues, ekipi negociator, lideri i këtij ekipi janë pjesë e detyrave dhe përgjegjësi të Kosovës.

Kosova është dhjetë vjet shtet i pavarur e sovran dhe lypet të demonstrojë gadishmëri, aftësi dhe kompetenca për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, duke përfshirë edhe proceset negociuese ndërkombëtare. Gatishmëria, aftësia dhe kompetencat për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, duke përfshirë edhe proceset negociuese përbëjnë në tërësinë e tyre një prej katër parimeve të së drejtës ndërkombëtare për shtetin, si subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare. Kosova duhet ta zbatojë këtë parim detyrues për shtetin. Asnjë faktor ndërkombëtar sado partner strategjik që të jetë nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë këtë detyrim ndërkombëtar të vetë Republikës së Kosovës. Transferimi i këtij detyrimi shtetëror të Kosovës tek faktorë të tjerë ndërkombëtar, qoftë edhe partnerë strategjikë, do ishte sa i pamundur aq sa edhe tregues i paaftësisë së Republikës së Kosovës për të përmbushur të drejtat dhe detyrimet e shtetit në marrëdhënie ndërkombëtare. Për Kosovën kjo është një sfidë e madhe. Është sfidë institucionale politikëbërëse dhe vendimmarrëse, sfidë lidhshipi politik, sfidë kapacitetesh diplomatike dhe ekspertize.

Në procesin e negociatave Kosovë-Serbi rolin udhëheqës e ka diplomacia. Diplomacia e Kosovës po qëndron e anashkaluar nga ky proces, po tregohet e plogësht dhe e paafte. Diplomacia e Kosovës është në krizë. Ajo është nën trysinë e politikës së ditës, e nënshtruar nga konjunkturën afatshkurtra, e toksikuar nga idetë, qëndrimet e veprimet e partiake dhe së fundi e gufatur në grackën bilaterale të lojës Serbe.

Diplomacia e Kosovës thuhet se ka harruar agjendën e saj të gjerë ndërkombëtare. Rënia në grackën e diplomacisë bilaterale serbe dhe lënia pas dorë e agjendës së gjerë ndërkombëtare të shtetit të Kosovës po e vetëzolon Kosovën, po tkurrë njohjet ndërkombëtare të saj dhe po ngadalëson dukshëm integrimin, qoftë edhe në organizata të veçanta. Ministri i Jashtëm i Kosovës, z. Pacolli, duket se nuk ka rolin e duhur në procesin e negociatave me Serbinë. Kjo nuk është për shkak të ndarjes së punës midis institucioneve, por është nga njëra anë për shkak të mënjanimet të tij politik nga të tjerët, nga ana tjetër për shkak të deficencave personale formuese e profesionale. Momenti historik i Kosovës thërret diplomacinë në krye të punëve. Diplomacia aktuale e Kosovës nuk është në nivelin e momentit historik.

Papa Françesku pranon dorëheqjen e kardinalit të Uashingtonit



VATIKAN, 12 TETOR - Papa Françesku pranoi dorëheqjen e kardinalit të Uashingtonit Donald Wuerl, që rezultoi të jetë i përfshirë në skandalin e abuzimeve seksuale që kanë tronditur kishën katolike. Donald Wuerl e mori detyrën këtë vit duke zëvendësuar kardi-

nalit Theodore McCarrick, kryepeshkopin e Uashingtonit i akuzuar për abuzime seksuale. Megjithatë ai ndodhej nën mbikëqyrje lidhur me trajtimin e rasteve të abuzimit seksual kur ishte peshkop i Pitsburgut në Pensilvani mes viteve 1988-2006.

Sipas gjetjeve të një jurie të madhe të Pensilvanisë, të bëra publike në muajin gusht, më shumë se 300 priftërinj katolikë kanë abuzuar seksualisht me të paktën 1 mijë fëmijë gjatë 70 viteve të fundit dhe udhëheqësit e kishës kanë bërë çmos për t'i mbuluar ato.

Trumpi, optimist për republikanët në zgjedhje

Parashikimi i presidentit Trump për zgjedhjet e 6 nëntorit, kur mandati i tij katërvjeçar ndodhet në gjysmën e parë, bie ndesh me prirjet historike që favorizojnë partinë politike jashtë pushtetit, në këtë rast demokratët, për zgjedhjet e mesmandatit



WASHINGTON, 12 TETOR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tha se është optimist për republikanët në zgjedhjet mbarëkombëtare për Kongresin muajin e ardhshëm, si dhe për rizgjedhjen e tij në vitin 2020.

Aktualisht republikanët kanë kontrollin e të dyja dhomave të Kongresit. "Mendoj se republikanët janë shumë të motivuar", u tha Trumpi intervistuesve në emisionin e preferuar prej tij, "Fox & Friends". Kjo, tha ai, për shkak të ekonomisë së fuqishme amerikane dhe konfirmimit javën e kaluar nga Senati kandidaturnë e gjyqtarit Brett Kavanaugh për në Gjykatën e

Lartë. "Unë vërtet besoj se do të dalim mirë. Mendoj se do të jemi të suksesshëm", tha presidenti. Parashikimi i presidentit Trump për zgjedhjet e 6 nëntorit, kur mandati i tij katërvjeçar ndodhet në gjysmën e parë, bie ndesh me prirjet historike që favorizojnë partinë politike jashtë pushtetit, në këtë rast demokratët, për zgjedhjet e mesmandatit. Përveç kësaj, sipas analistëve të pavarur që u referohen anketave, demokratët janë gati të marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve, ndërkohë që republikanët ka gjasa të ruajnë shumicën e tyre të vogël në Senat.

Presidenti Trump tha se nëse demokratët marrin kontrollin e Dhomës, "ne do të na duhet të luftojmë deri në fund" gjatë dy viteve të ardhshme sepse ka një grumbullim urrejtjeje kundër tij dhe politikave të tij. Disa demokratë kanë thënë tashmë se në qoftë se marrin shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve, ata kanë në plan t'i nisnin procedurat

e shkarkimit kundër presidentit Trump si dhe hetimin e financave të tij personale apo programeve qeveritare që ai ka ndryshuar pas ardhjes në Shtëpinë e Bardhë në janar 2017.

Megjithatë, Trumpi tha se nëse demokratët marrin Dhomën, ka mundësi që të shkojmë mirë së bashku, sepse ai dhe demokratët mund të arrijnë marrëveshje për

shpenzimet e infrastrukturës, pasi të dyja partitë do të dëshironin riparimin e autostradave dhe urave të rrënuara të vendit. Sa i përket vitit 2020, Trumpi nuk pranoi të thoshte nëse nga demokratët ka ndonjë rival të mundshëm, të cilit do t'i frikësohej në garën për një mandat të dytë katërvjeçar.

Disa demokratë, përfshirë ish-nënpresidentin Joe Biden, thonë se nuk do të jenë gati të thonë para fundit të vitit nëse do të fillojnë një fushatë mbarëkombëtare kundër Trumpit. Presidenti Trump tha se me ekonominë në gjendje të mirë, "nuk e kuptoj se përse pse nuk do të dilja mirë në zgjedhje. Brenda më pak se dy viteve ne kemi më shumë se çdokush tjetër në histori", tha ai. Megjithatë, sondazhet tregojnë se votuesit vazhdimisht nuk e miratojnë punën e presidentit Trump në detyrë. Aktualisht rreth 53 për qind nuk e pëlqejnë punën e tij kundrejt 43 për qind që e miratojnë atë.

Powell refuzon emërimin ambasadore e ShBA-së në OKB



Uashington, 12 tetor - Shefja ekzekutive në Wall Street, Dina Powell, të cilën Shtëpia e Bardhë e ka përmendur si kandidatë të mundshme për ambasadore amerikane në Kombet e Bashkuara, është tërhequr vetë nga përzgjedhja potenciale, kanë raportuar agjencitë e lajmeve. Udhëheqësja e bankës për

investime, Goldman Sachs është tërhequr si kandidatë potenciale për të zëvendësuar ambasadoren amerikane, Nikki Haley në OKB, kanë raportuar Reuters dhe AP, duke cituar zyrtarë anonimë. Këto agjenci kanë raportuar se Powell i ka thënë presidentit amerikan, Donald Trump në një bisedë telefonike se ajo është e nderuar që emri i

saj është përmendur, mirëpo planifikon të qëndrojë në pozitën e saj në bankë.

Trumpi ka biseduar me Powell këtë javë rreth pozitës në OKB, pasi Haley ka njoftuar papritur këtë javë për planet e largimit. Powelli ka shërbyer në Shtëpinë e Bardhë më herët si zëvendëskëshilltare për Siguri Kombëtare.

Lideri jugkorean është optimist për përfundim të Luftës Koreane

SEUL, 12 TETOR - Presidenti jugkorean, Moon Jae-in i ka thënë BBC-së, se është çështje kohe para se Shtetet e Bashkuara dhe Koreja Veriore të shpallin fundin e gjendjes së luftës në Gadishullin Korean. Lufta në këtë Gadishull ka përfunduar më 1953 mirëpo trak-

tati i paqes nuk është nënshkruar kurrë. Moon, ka thënë se mund të ketë më shumë "plagë e dhimbje" diplomatike, teksa tenton të bindë liderin verikorean, Kim Jong-un për të hequr dorë nga armët bërthamore. Megjithatë, ai e ka përkrahur



Kimin si njeri të sinqertë. Në një intervistë për BBC-në ai po ashtu ka thënë se shpreson që liderët evropianë t'i ndihmojnë atij si ndërmjetësues në mes të Kimit dhe presidentit amerikan, Donald Trump nëse negociatat ngecin. Moon dhe Kim janë takuar tri

herë gjatë këtij viti dhe ai ka shërbyer edhe si ndërmjetës mes liderit verikorean dhe Trumpit. Ai ka thënë se ka pasur diskutime të shumta me presidentin Trump dhe zyrtarë tjerë amerikanë lidhur me dhënie fund të gjendjes së luftës.


Turqia liron pastorin amerikan

ANKARA, 12 TETOR - Një gjykatë turke vendosi të premtën të lirojë pastorin e krishterë evangjelist amerikan Andrew Brunson, çështja e të cilit ka qenë në qendër të përplasjeve diplomatike mes Ankarasë dhe Uashingtonit. Vendimi mund të

jetë hapi i parë drejt përmirësimit të marrëdhënieve mes dy aleatëve të NATO-s. Gjykata miratoi një dënim prej rreth 3 vitesh për Andrew Brunson-in, i cili ishte akuzuar për vepra terroriste, por për shkak të arrestimit të tij prej

tetorit 2016 ajo vendosi për lirin e pastorit. Sipas dëshmitarëve, Brunson u emocionua gjatë momentit të njoftimit të vendimit. Përpara se gjyqtari të jepte vendimin pastorin i tha gjykatës: "Jam i pafajshëm. E dua Jezusin dhe Turqinë".





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme
mund të merren në numrin e telefonit
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë
në celularin 044-166-580.**

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Restoranti më i madh nënujor, drejt fundit

Restoranti i parë nënujor i Evropës është shumë pranë përfundimit. I ndodhur pesë metra nën sipërfaqen e Detit të Veriut, shumë pranë pikës më jugore të Norvegjisë, struktura 33.5 metra e gjatë, një pllakë betoni e pjerrët që duket si një periskop i mbytur, është zhytur në korrik të këtij viti. Tashmë ka



nisur puna për ta kompletuar brendinë e tij, mes pritjeve të ethshme për t'u hapur për publikun në pranverën e vitit 2019.

FOTO E DITES



Një aeroplan zjarrfikës kalon mbi një zjarr pranë kufirit Izrael dhe Gaza. /AP/

E rrallë

U dehën aq keq sa blenë hotelin

Të gjithë bëjnë çmenduri kur dehen, por pak veta blejnë hotelin ku pushojnë. Një çift 35-vjeçarësh nga Londra ishin për muaj mjalti në Sri Lanka dhe te hoteli ku pushonin ata zunë shumë miqësi me stafin. Në një prej atyre ditëve, pas 12 gotash rum, ata panë që hotelit po i mbaronte kontrata e përdorimit, ndaj vendosën ta blejnë biznesin për tre vjet, me një



kosto gati 40 mijë dollarësh në total. Çifti firmosi dokumentet, edhe pse çdo gjë u zhvillua në një gjuhë që nuk e merrnin vesh.

BARSOLETA E DITËS



Burri duke dhënë shpirt:
Burri: Grua, më fal, të kam gënjer! Gjithë ato net që të thosha se jam në punë deri vonë, unë isha me femra të tjera. Të kam tradhtuar me to!
Gruaja: E dija, e dija, prandaj ta dhashë helmin.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Pas disa çastesh tensioni dhe


nervozizmi, çdo gjë do të qetësohet dhe ju do të rimerrni energji pozitive nga një person i afërt.



DEMI

Një zë i brendshëm sot nuk po ju

lejon të shpreheni hapur dhe pa rezerva. Mund ta dëmtoni veten nëse do të flisni hapur për një situatë të caktuar.



BINJAKËT

Në disa opsione që mund t'ju serviren

sot gjatë ditës ju do të dini ta zgjidhni më të mirin. Arsyeshëm sot do të vendosni për një punë.



GAFORRJA

Intuita nuk ju lë në baltë dhe ju

ndihmon të mos përfshiheni në debate që s'ju përkasin. Sensibël me kë ju qëndron pranë, do të jeni mjaft mbështetës.



LUANI

Nuk do të jetë një ditë aspak e

thjeshtë kjo e sotmja. Do të keni mjaft debate në punë dhe kundërshti mendimesh me kolegët.



IRGJËRESHA

Keni mësuar ta ruani qetësinë

dhe të mos reagoni me impulsivitet. Jeni të durueshëm t'i dëgjoni të tjerët deri në fund.



PESHORJA

Keni harxhuar kohë të vyer duke u

marrë me gjëra që janë jashtë interesit tuaj. Sot jeni ndërgjegjësuar dhe nuk do të pranoni asnjë devijim nga planet tuaja.



AKREPI

Po kaloni në një terren që edhe në të

shkuarën ju ka shkaktuar neveri, por të kondicionuar nga situata të caktuara, sot nuk keni si të veproni.



SHIGJETARI

Po e shihni veten me më tepër

besim dhe po kuptoni se gjërat për të cilat keni luftuar prej kaq kohësh, vërtet ia vlejnë.



BRICJAPI

Po lejoni që persona të caktuar

t'ju kritikojnë pa asnjë arsye dhe mosreagimi juaj ju jep të drejtën të vazhdojnë ta bëjnë.



UJORI

Sot do të realizoni shumë mirë një

projekt që ju është caktuar. Nëse e shtyni për më vonë do të keni mjaft pengesa dhe probleme.



PESHQIT

Sot është një ditë jo si gjithë të

tjerat dhe lajmi që keni marrë do ta bëjë më interesante. Ju pëlqen të eksperimentoni me të rejat.

Amy Winehouse, turne muzikor në vitin 2019



Amy Winehouse do të kthehet në skenë me anë të një hologrami për të zhvilluar një turn në vitin 2019. Kjo gjë do të ndodhë pikërisht shtatë vjet pas vdekjes tragjike të këngëtares nga alkooli në moshën 27-vjeçare. BASE Hologram do të mund të


krijojë një pamje virtuale të yllit të muzikës dhe më pas ajo do të zhvillojë koncerte me këngët e saj. Të ardhurat për turneun do të shkojnë drejt Fondacionit Amy Winehouse dhe lajmin e ka bërë me dije babai i saj, Mitch.

Ben Afflecku ndahet nga modeluesja e njohur



Ben Afflecku e ka shkëputur lidhjen me Shauna Sexton pavarësisht se modeluesja pretendon se ajo dhe aktori janë ende të bashkuar. Një mik i Affleckut ka thënë për "Just Jared": "Ben dhe Shauna nuk janë më bashkë". Ky burim ka treguar se ish-

bashkëshortja e tij, Jennifer Garner, nuk ishte e kënaqur me marrëdhënien e tij të re. Ndërsa kur modeluesja u pyet nga "Daily Mail" javën e kaluar, në lidhje me marrëdhënien me aktoren, ajo u përgjigj: "Mos besoni gjithçka që lexoni në internet".



Kourtney Kardashian kapet sërish me të dashurin e ri

Kourtney Kardashian dhe i dashuri i saj i përfolur, Luka Sabbat, u panë duke vizituar galerinë e bardhë në Beverly Hills në Kaliforni. 39-vjeçarja dhe aktori 20-

vjeçar u fotografuan së bashku në vazhdim të thashethemeve se ata janë në lidhje. "Nuk ka asgjë serioze tani për tani", ka thënë një burim për "People".

Dueti i ëmbël i Keith Urbanit dhe Nicole Kidmanit

Keith Urban dhe Nicole Kidman kanë realizuar një duet shumë të ëmbël. Në nderim të Ditës Ndërkombëtare të Vajzës, çifti është ulur së bashku në pianon e tyre për të interpretuar një version shumë të bukur të këngës së njohur të këngëtarit të muzikës country, "Female". Urban ka shpërndarë videon në llogarinë e vet në "Instagram", duke treguar se ky moment i veçantë në shtëpinë e



tyre është xhiruar nga dy vajzat e çiftit, Sunday (10) dhe Faith (7).

Greqi-Gjermani, kush i ka borxh kujt!?

Greçia i ka borxh Gjermanisë miliarda euro. Apo e kundërta? Athina edhe 70 vjet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kërkon pagesën e dëmeve.

Për ndërhyrjes ushtarake në Greçi, në maj të vitit 1941, trupat e Hitlerit kanë vënë flamurin nazist mbi Akropol në Athinë. Deri në vitin 1944 ka zgjatur okupimi gjerman i këtij vendi. Gjatë kësaj kohe trupat naziste kanë vrarë shumë grekë dhe kanë plaçkitur shumë pasuri në mbarë vendin. Dëmet ekonomike nga lufta dhe okupimi edhe sot janë një temë grindjeje mes Greqisë dhe Gjermanisë.

Një komision i ekspertëve të Parlamentit grekë ka llogaritur në vitin 2015 se dëmet e luftës kanë qenë të paktën 289 miliardë Euro. Qeveria gjermane ka hedhur poshtë këto kërkesa, me pohimet se të gjitha obligimet gjermane për dëmet e luftës në Greçi janë paguar më parë. Por kjo çështje ngarkon raportet mes Gjermanisë dhe Greqisë edhe sot. Athina kërkon që këto dëme të luftës të paguhet.

Mënyra e pagesës

Në njërën anë bëhet fjalë për dëmet direkte të bëra nga trupat gjermane në kohën e Luftës së Dytë Botërore, plaçkitjet, vrasjet dhe shkatërrimet. Gjermania u ka paguar viktimave të krimeve të trupave naziste në Greçi 115

milionë Marka. Sipas një marrëveshje nga viti 1960, Gjermania ka qenë e detyruar të paguajë dëmet në bazë të kërkesave individuale.

Por Greçia kërkon pagesa edhe për shkak të huave të imponuara shtetërore. Gjermania e ka detyruar Bankën Qendrore greke në vitin 1942 që t'u japë hua forcave gjermane atje, pa kurrfarë interesi, 476 milionë Marka. Me këto para Gjermania e atëhershme ka financuar kostot e okupimit të Greqisë. Këto para nuk janë paguar nga pala gjermane. Një komision i ekspertëve grekë është i mendimit se Gjermania mbi këtë bazë i ka borxh Greqisë rreth 11 miliardë Euro.

(Mos)marrëveshjet

Qeveria gjermane pohon se kjo çështje ka përfunduar. Për këtë çështje është mbajtur një konferencë në vitin 1945 në Paris. Këtu u janë paguar grekëve një përqindje e reparacioneve nga Lufta e Dytë Botërore. Greçia ka marrë gjëra në vlerë (vlera e sotme) prej rreth dy miliardë Euro.

Me Marrëveshjen e nënshkruar në Londër, në vitin 1953, fuqitë perëndimore kanë rënë dakord



që kërkesat e tjera të shtyhen deri në nënshkrimin e një marrëveshje paësore. Ndërkohë që

Gjermanisë i është garantuar një falje e borxheve. Por kjo marrëveshje e paqës mes

Gjermanisë dhe vendeve të tjera nuk është nënshkruar kurrë. Në vend të kësaj, në vitin 1990 është futur në fuqi e ashtuquajtura "Marrëveshja-dy-plus-katër" për ribashkimin e Gjermanisë, e cila është njohur edhe nga Greçia. Kjo Marrëveshje nuk parashikon pagesa të tjera për dëmet.

Burxhet e reja, problemet e reja

Çështja e pagesave për dëmet e luftës ndaj Greqisë është hapur sërish pas krizës financiare dhe buxhetore të Greqisë, në vitin 2010. Athina ka kërkuar nga Bashkimi Evropian ndihma për të evituar falimentimin e shtetit. Ajo ka marrë kredi në borxhe prej rreth 274 miliardë Euro, ndër to të paktën 55 miliardë Euro nga Gjermania. Disa politikanë mendojnë se këto borxhe mund të mos kthehen dhe të llogariten si pagesa për borxhet e kohës së Luftës së Dytë Botërore. Por shumica dëmtuese e ekspertëve mendon se negociatat të reja për pagesën e dëmeve, 70 vjet pas përfundimit të Luftës, nuk do të ketë.

(gazeta-Shqip.com) / DW



Historia e Ruby-t dhe Ronaldos: Më dha 4000 euro pas një nate, por...

Fjalët në një procesverbal të vitit 2010. Ish-modelja atëherë minorene foli për një marrëdhënie me lojtarin, por pastaj burrit të saj i thotë: "Kam shpikur gjithçka". Dhe sot në një mesazh avokatit: "Jam e mërzhitur, emri im është shfrytëzuar"

Ishte ora 09:50 e 22 korrikut 2010. Karima El Mahroug ishte vetëm 17 vjeç (ajo ka lindur në nëntor të vitit 1992) dhe është ulur përpara zëvendësprokurorit të atëhershëm të Milanos, Pietro Forno dhe një inspektori policie në një dhomë të komunitetit që e strehon atë në Gjenova. Në këtë hetim brenda pak muajsh është përfshirë edhe kryeministri i atëhershëm, Silvio Berlusconi, i cili më pas u ndjek penalisht i akuzuar për marrëdhënie seksuale me një

përpoq të hyjë në stacionin e Lele Mora, atëherë agjent shumë i rëndësishëm, me qëllim të kalimit të dyerve të modës apo argëtimit, por nuk ia doli. Shkon nëpër klubet e natës, përfundon në shtëpinë e Silvio Berlusconi në Arcore gjatë darkës, por nuk ka dëshmi se në vilën e kryeministrit dikush e dinte se ishte e mitur.

Deri në maj të vitit 2010 nuk është ndaluar nga policia për dëmet e shkaktuara një të panjohure. Silvio Berlusconi ajo i



vajzë minorene. Ruby mbushi faqet, në të cilat u përzien edhe fakte reale, verifikuar më vonë nga hetuesit, për të kompletuar shpikjen, rrethanat në të cilat as edhe një test minimal nuk është gjetur.

Ashtu si çështja me Cristiano Ronaldon, lojtarin aktual të Juventusit. Në atë moment, Karima është një vajzë e humbur. Ajo u largua nga shtëpia duke lënë familjen në Letojanni (Messina), arriti në Milano ku u

kishte thënë se ishte mbesa e presidentit të atëhershëm egjiptian, Mubarak. Edhe kjo ishte një histori e rreme.

"Në 13.40 Rubi fillon të flasë për Ronaldon me kryeministrin"

"Unë kurrë nuk kam prostituuar, as nuk kam pranuar marrëdhënie seksuale të paguara; Kam pasur marrëdhënie sek-



suale me djemtë që më pëlqenin. E vetmja herë që unë jam paguar ka qenë për një marrëdhënie seksuale që kisha me futbollistin Cristiano Ronaldo që e njoha më 29 janar 2009". Ajo thotë se u takua me CR7 në një klub nate në Milano, Hollywood, ku e dinte se ai ishte aty. Donte ta shihte atë thjesht nga kurioziteti. "Ndërsa kalova, ndalova te Ronaldo", shtoi ajo në procesverbal, "më ka komplimentuar dhe kemi shkëmbyer numrat e telefonit". Këtu ajo kundërshton veten: së pari tha se kishte shkuar në klub për të parë lojtarin që ishte "i famshëm", pastaj shtoi se nuk e dinte se kush ishte ai. Kështu ajo tregoi se e kishte parë sërish për darkë në një restorant. "Unë kurrë nuk i kam treguar atij moshën që në mbrëmjen e

pare", tha ajo, duke shtuar se e kishte takuar disa herë atë derisa ata vendosën të shkonin në shtrat në hotelin e famshëm të qytetit, Princi i Savojës, ku "ai tashmë po qëndronte" në katin e pestë.

Askush në hyrje nuk do të kishte kërkuar dokumentet

Të nesërmen, futbollisti ka ikur pa u zgjuar ajo, duke i lënë një shënim në tryezën e krevatit, në të cilën i shkruante: "Shpresoj që kur të kthehem, mos të të gjej në dhomën time". Në tryezën e krevatit ishin 4.000 euro në para cash. Ajo thotë se kishte filluar të qante dhe kur u takuan përsëri me Ronaldon në një tjetër klub nate, ia kishte përpla-

sur në fytyrë paratë. Të dy do të takohen përsëri, në historinë e Ruby, në qendër të Milanos.

"Ai kërkoi falje për sjelljen e tij, duke thënë që mendonte se vajza ishte si gjithë të tjerat dhe se kërkonte vetëm para prej tij. Asnjë nga pretendimet e Karima El Maha, por për Ronaldon nuk gjeti ndonjë dëshmi. Për hetuesit, ishte fantazi e pastër. Ajo ia konfirmon këtë partnerit të saj, duke thënë se ajo ka shpikur gjithçka. Ndërsa, edhe para gjyqtarëve e kishte përsëritur se kishte thënë shumë gënjeshtër. Në gjyqet e ndryshme mbrojtësit, para së gjithash nga ajo e Silvio Berlusconi, kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur që Ronaldo të merret në pyetje në gjykatë për të demonstruar pabesueshmërinë e të rinjve marokenë. Por, gjyqtarët mendonin se dëshmia e yllit të futbollit ishte plotësisht e re.

"Jam e mërzhitur. Edhe një herë e shoh emrin tim të shfrytëzuar për qëllime të tjera".

Këto janë fjalët për rastin Ronaldo të shkruara nga Ruby, në një mesazh të dërguar të martën në mëngjes tek avokatja e saj, Paola Boccardi. Karima mohon atë që është raportuar në akuzat amerikane kundër kampionit të Juventusit, duke iu referuar një artikulli të botuar nga tabloidi anglez "Sun" në të cilin sipas avokatit Leslie Stovall – avokati i Katryn Mayorga, SHBA që akuzon lojtarin e Juventusit për përdhunim – do të fliste për tre gra të tjera që do të akuzonin Ronaldon për ngacmime. Në të njëjtën shkrim është vënë edhe emri i Ruby, e cila në deklaratat përpara prokurorëve italianë kishte thënë se kishte pasur marrëdhënie seksuale me pagesë me lojtarin portugez. Një histori pastaj e mohuar nga vetë Karima. (gazeta-Shqip.com)



10 gabimet që nuk duhet të bëjmë kur jemi në restorant



Të uleni vetë

Nëse kamerieri është i zënë, të uleni vetë në tavolinë mund të duket si një mënyrë e lavdërueshme për ta ndihmuar atë, por në fakt është e kundërta e saktë, sepse kamerierët kanë një sistem të saktë për shpërndarjen e konsumatorëve në tavolina të ndryshme dhe e bëjnë këtë në mënyrë që restoranti të funksionojë normalisht. Këshilla: nëse kamerieri është i zënë në momentin që arrini ju, kur të mbërrini, pritni të paktën disa minuta para se të telefononi dikë.

Të grumbulloni pjatat

Ideja është që të bëni një favor për kamerierin, por gjesti është shumë më pak i dobishëm se sa mund të mendoni, sepse kamerierët kanë një mënyrë të veçantë për të grumbulluar pjatat dhe për t'i çuar në kuzhinë pa rrezik. Këshilla: lini

pjatat në vendin e tyre në tavolinë, në mënyrë që ato të mund të mblidhen individualisht.

Të hiqni pjatat

Qëllimi i lavdërueshëm për të raportuar se keni mbaruar së ngrëni dhe për këtë arsye pjatat mund të merren, në vend të kësaj, bëhet një burim shqetësimi për kamerierin, i cili do të ketë më shumë vështirësi në pastrimin e tryezës. Këshilla: mbani pjatat para jush dhe prisni që kamerieri t'ju pyesë nëse keni mbaruar.

Të urdhëroni një tjetër kamerier

Nëse kamerieri që ju ka shërbyer deri më tani është i zënë, pse të mos kërkonti një tjetër që t'ju sjellë ëmbëlsirë? Thjesht, sepse duke bërë kështu mund të komplikohen gjërat edhe kur është fjala për të bërë faturën. Këshilla: lutuni me dashamirësi

një tjetër kamerieri që t'i tregojë kolegut të tij se keni nevojë për atë.

Të pastroni pas një aksidenti

Aksidentalisht rënia e një xhami nga tryeza mund të ndodhë dhe ideja për të minimizuar shqetësimet e personelit, duke pastruar dëmin nga ju është e lavdërueshme, por në realitet gjëja e fundit që stafi dëshiron është që ju të hiqni copat e xhamit. Këshilla: lini kamerierët ta bëjnë këtë dhe kufizoni veten me justifikimet (të cilat janë pa dyshim minimumi).

Të bisedoni me kamerierin

Edhe në këtë rast ju thjesht dëshironi të jeni miqësor dhe i sjellshëm, por nëse vendi është plot, është mirë të minimizoni bërtitjen me stafin, të cilët mund të vazhdojnë të bëjnë punën e tyre. Këshilla: një

buzëqeshje e bukur dhe një tip i mirë është mënyra më e mirë për të treguar vlerësimin tuaj për shërbimin e marrë.

Të porosisni në një gjuhë që nuk njihet

Përveçse mund të dukeni qesharakë, mund të krijohet konfuzion edhe me pjatat. Këshilla: i porosisni pjatat ashtu siç janë të shkruara në menu dhe kamerieri do t'ju falënderojë.

Rrini të qetë

Nëse diçka nuk ju pëlqen, qëndroni të heshtur në mënyrë që të mos shqetësoni stafin, pasi nuk është një gjest i sjellshëm, siç duket, sepse përfundon vetëm duke krijuar një pakënaqësi në rritje, e cila do të rezultojë në një tip të dobët. Këshilla: kamerieri është aty edhe për të dëgjuar ankesat tuaja, por nuk mund ta lexojë mendjen tuaj.

Të ndihmoni me tabakanë

Kur kamerieri arrin në tryezë me një tabaka plot me pije apo ushqim, gjithçka është e balancuar në mënyrë të përkryer. Kjo është arsyeja pse përpjekja juaj për ta ndihmuar atë duke hequr një pjesë të peshës mund të jetë katastrofike. Këshilla: nëse doni të jeni me të vërtetë të dobishme, lëvizni çdo send personal që është në tavolinë, në mënyrë që kamerieri të ketë hapësirë për të vendosur tabakanë.

Të ndani faturën në fund

Të prisni fundin e vaktit për të ndarë faturën nuk është gjë tjetër veçse një favor për kamerierin ose restorantin. Këshilla: Paralajmëroni paraprakisht se keni ndërmend të ndani faturën sepse kështu përshpejtohen tërë veprimet.

(gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	SLOVAKIA - CZECH REPUBLIC	1	REP OF IRELAND - DENMARK	3+	BULGARIA - CYPRUS	1
-------------------	---------------------------	---	--------------------------	----	-------------------	---

Kastrioti, Prishtina dhe Besa në Evropë

Tri klubet elitare të hendbollit në Kosovë, Kastrioti, Prishtina dhe Besa Famgas, do të paraqiten në këtë fundjavë në garat ndërkombëtare. Kastrioti synon të shkruajë historinë duke kaluar rrethin, kurse për kualifikim luan edhe Prishtina. Besa e ka humbur ndeshjen e parë, por synon ta përmbyllë aventurën ndërkombëtare me fitore



u paraqit mirë, por në fund pësoi humbje me rezultat të thellë (37:26). "Jemi duke u përgatitur mirë që të shënojmë fitore. Tash e njohim mjaft mirë kundërshtarin, por për t'u kualifikuar më tutje shanset janë të vogla, pasi Drammenin është një ekip i fortë dhe më i mirë se ne. Besoj se me ndihmën e shikuesve dhe duke shfrytëzuar terrenin vendës, mund të fitojmë. Fitorja e ekipit tonë do të ishte e mirë për gjithë hendbollin e Kosovës, natyrisht edhe për lojtarët tanë dhe për ecurinë e mëtejme të tyre", ka thënë Muqolli, duke lënë të nënkuptohet se kualifikimi për Besën është një mision i pamundur.

paraqitet edhe Prishtina. Skuadra nga kryeqyteti i Kosovës përballet me skuadrën nga Ukraina, ZNTU-ZAB Zaporozhye. Ndeshjet Prishtina - Zaporozhye luhen në kuadër të rrethit të dytë të Kupës Sfiduese, apo Challenge Cup, kurse beson se mund ta eliminojë skuadrën ukrainase. "Ekipi ZNTU-ZAB Zaporozhye është shumë i fortë, por do ta japim maksimumin dhe do të mundohemi t'i befasojmë ukrainasit", ka thënë trajneri i Prishtinës, Taib Kabashi. Ndeshja e parë luhet të shtunën

nga ora 17:30, kurse e dyta të dielën nga ora 14:00, kurse të dyja zhvillohen në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Në këtë fundjavë në garat ndërkombëtare do të paraqitet edhe Besa Famgas. Trajneri i skuadrës pejane, Arben Muqolli, e ka pranuar se skuadra e Drammenit nga Norvegjia është më e mirë se skuadra pejane, por pret fitore sonte (e shtunë) në ndeshjen kthyesë që zhvillohet në palestren "Karagaçi". Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Norvegji, Besa

Lidhur me ndeshjen e parë të zhvilluar në Norvegji, Muqolli deklaroi: "Në Norvegji kemi pritur një rezultat më të mirë, por nuk ndodhi ashtu. Deri në mesin e pjesës së dytë qëndruam mirë, por në fund na lëshoi forca për arsye se momentalisht bankën e kemi me lojtarë të rinj. Nuk po kemi mundësi të bëjmë shumë ndërime në lojëra të forta si këto me Drammenin".

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 12 TETOR - Skuadra e hendbollit nga Ferizaj, Kastrioti, do të luajë në këtë fundjavë në garat ndërkombëtare. Kjo skuadër asnjëherë nuk ka kaluar rrethin dhe këtë gjë synon ta bëjë në kuadër të rrethit të dytë të Kupës Sfiduese (Challenge Cup). Kundërshtarë e Kastriotit është skuadra nga Estonia, Tallinn. Të dyja ndeshjet luhen në palestren "Bill Clinton" në Ferizaj dhe kjo është një përparësi e madhe për skuadrën e Kastriotit. Ndeshja e parë luhet të shtunën nga ora 19:00, ndërsa e dyta të dielën nga ora 19:00. "Atmosfera është shumë e mirë, lëndime nuk kemi dhe lojtarët janë të motivuar që ta japim maksimumin, që ta thyejmë

akullin dhe të kualifikohemi në raundin tjetër të garave. Ekipi kundërshtar për herë të parë merr pjesë në gara evropiane, por është lider në kampionatin vendor. Ka lojtarë të rinj që armën kryesore e kanë lojën e shpejtë me kundërsulme dhe gjysmë kundërsulme", ka thënë trajneri i Kastriotit, Verim Zherka. "Përvoja dhe kualiteti është në anën tonë dhe djelmoshat do të bëjnë çmos që KH Kastrioti për herë të parë ta kalojë raundin dhe t'i vazhdojë garat në kupat evropiane. Shfrytëzoj rastin të bëj apel te të gjithë hendboll-dashësit ferizajas që të shtunën e të dielën të vijnë në numër sa më të madh që ta përkrahin klubin e tyre të zemrës, klubin e krenarisë së qytetit".

Përveç Kastriotit, sonte (e shtunë) në gara ndërkombëtare do të

Bylbyl Sokoli falënderon të gjithë në KF Llapi, por jo drejtorin Batatina

PRISHTINË, 12 TETOR - Trajneri Bylbyl Sokoli nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka falënderuar të gjithë ata që kanë punuar në skuadrën e Llapit, por jo edhe drejtorin sportiv, Tahir Batatina. Duket se problemet e krijuara në skuadrën nga Podujeva dhe largimi i kryetarit Nexhat Dumnica dhe disa prej aksionarëve të klubit erdhi pikërisht pas shkarkimit të "Profës" nga detyra e trajnerit. "Një falënderim për 'Legjendat' e KF Llapit, për simpatizantët, qytetarët dhe të gjithë ata që e përkrahin Llapin ngado që vijnë brenda dhe jashtë Kosovës. Një falënderim për bordin (kryesinë) e KF Llapit në krye me Nexhat Dumnicën. Falënderim për shtabin teknik, ndihmëstrajnerët, doktorin, fizioterapeutët si dhe sekretarin e klubit. Falënderim futbollistëve të KF Llapit për angazhimin e tyre! Falënderim

për një bashkëpunim të derisotëm, duke dëshiruar suksese të gjithëmbarshe e suksese të reja Llapit. Largohem me ndjenjat, që edhe këtë moment të jap një kontribut, sikur edhe atëherë kur erdha në Llap", ka shkruar Sokoli.



U21, përgatitje intensive për ndeshjen kundër Izraelit

PRISHTINË, 12 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës U21 po vazhdon përgatitjet për ndeshjen ndaj Izraelit, e cila do të zhvillohet më 16 tetor në Tel Aviv. Ndihmëstrajneri Erdogan Celina ka thënë se përgatitjet po bëhen seriozisht për ndeshjen ndaj izraeliteve, kurse vlerëson se pjesëmarrja në këto kualifikime ka qenë një përvojë e mirë. "E kemi marrë ndeshjen kundër Izraelit shumë seriozisht dhe po përgatitemi me përkushtim. Dihet se kjo ishte pjesëmarrja jonë në kualifikime dhe kemi krijuar një përvojë të mirë si ekipi, si stafi, prandaj duam që këtë cikël ta mbyllim sa më mirë. Në këtë grumbullim kemi



marrë edhe disa lojtarë të rinj, pasi duam ta krijojmë ekipin për ciklin e ardhshëm kualifikues dhe sigurisht se në të ardhmen do ta kenë hapësirën për t'i dëshmuar cilësitë e tyre", ka thënë Celina.

Lajm i keq për Kosovën, Kololli mungon ndaj Ishujve Faroe

PRISHTINË, 12 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të dielën do të përballet me Ishujt Faroe pa mbrojtësin Benjamin Kololli, i cili është lënduar në ndeshjen ndaj Maltës (3-1). Kololli të enjten në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" ishte ndër më

meritoret për fitoren e Kosovës pasi shënoi dy gola. "Për shkak të një lëndimi të mëhershëm dhe të ripërtëritjes së sërishme gjatë ndeshjes Kosova - Malta, futbollisti Benjamin Kololli nuk do të mund të jetë pjesë e ekipit në ndeshjen e ardhme Ishujt Faroe - Kosova. Shtabi teknik i

ekipit përfaqësues është duke shikuar mundësitë për të gjetur një zgjidhje dhe për ta ftuar një futbollist tjetër si zëvendësim për Kolollin, i cili do të kthehet në shtëpi dhe nuk do të udhëtojë në Ishujt Faroe", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit.



Nadali: Me Federerin bëjmë sport, jo luftë

CYRIH, 12 TETOR - Tenistët Roger Federer dhe Rafael Nadal kanë krijuar një miqësi të jashtëzakonshme mes tyre në vitet e fundit, duke bërë që rivaliteti në fushë të qëndrojë i tillë vetëm

brenda lojës, por jashtë saj ata janë miq të mirë. Madje zvicerani ishte i vetmi i ftuar "Vip" që spanjulli Nadal pati kur inauguroi Akademinë e tij dy vjet më parë. "Arsyeja që ne shkojmë

mirë është se të dy e kuptojmë se ky është sport. Ne të dy e kuptojmë se çfarë ndodh brenda fushës dhe çfarë jashtë saj. Ndeshjet i fiton në fushë, lufton në fushë, por kur ndeshja

përfundon është një jetë tjetër. Loja nuk është gjëja kryesore në jetën tonë dhe ne të dy e kemi kuptuar këtë gjë, që ky është sport dhe jo luftë, gjë që duhet ta mësojnë të gjithë", ka thënë Nadali.



Berisha: Ju tregoj si kualifikohemi

TIRANË, 12 TETOR - Etrit Berisha u aktivizua për 90 minuta gjatë miqësore me Jordaninë, duke u rikthyer në rolin e titullarit. Portieri i Atalantës është paraqitur në konferencën për shtyp dhe ka folur për miqësoren e së mërkurës dhe ndeshjen me Izraelin në Ligën e Kombeve. Kuqezinjtë e Panuccit do të përballen me ekipin izraelit ditën e diel në transfertë, ndërsa Berisha mendon se edhe një barazim në këtë ndeshje nuk është rezultat i keq. "Mundësitë janë reale, duke marrë parasysh edhe lojën e djeshme. E pamë se është skuadër e fortë, por mundësitë janë reale që të marrim rezultat pozitiv. Po ashtu, duke marrë parasysh që Izraeli fitoi dje, i bie që, nëse marrim rezultat pozitiv, ndeshja me Skocinë do të vlejë pak. Jemi të motivuar dhe e dimë rëndësinë e kësaj ndeshjeje", ka thënë Berisha, i cili ka treguar se është i qetë dhe se po punon shumë.

Lidhur me skuadrën e Izraelit, Berisha ka deklaruar: "E kemi ndjekur të gjithë bashkë ndeshjen e Izraelit. Në pjesën e parë



dominoi më tepër Skocia, ndërsa në pjesën e dytë Izraeli kishte kurajë dhe krijoi shumë raste dhe arriti ta fitonte ndeshjen në fund. E njohim kundërshtarin se ka kualitet, por dhe ne po rritemi si

skuadër dhe kjo ndeshje do të jetë një nga sfidat decizive për të dalë të parët e grupit. Barazimi nuk do të ishte i keq, por them se ndeshja decizive do të jetë me Skocinë".

Pensionohet skiatorja më e mirë në histori

UASHINGTON, 12 TETOR - Skiatorja amerikane Lindsey Vonn, 34 vjeçe, ikona e garave me ski, do të zbresë në pistë për të fundit herë këtë sezon (2018-2019), që nis në fund të tetorit. Deri më tani në karrierën e saj ka fituar 82 gara, si asnjë femër tjetër, ndërkohë që para saj, me 86 fitore, është vetëm suedezi Ingemar Stenmark, kampioni absolut i garave të Kupës së Botës në ski. Vonnin i ka vënë si objektiv vetes këtë sezon që të arrijë të paktën pesë fitore dhe ta thyjë këtë rekord, por ky është vetëm një dëshirë dhe jo një makth. Edhe në rast se nuk arrin ta realizojë këtë objektiv, për skiatorin bukuroshe amerikane nuk ka kthim mbrapa, ajo do ta mbyllë karrierën në fund të këtij sezoni. "Fizikisht, kam arritur në një pikë ku nuk ka më asnjë kuptim që të vazhdoj të garoj. Natyrisht se dua të jem aktive, çka do të thotë që do të vazhdoj të merrem me sport edhe në të ardhmen, duke menduar për atë



që do të vijë", ka thënë Vonnin, që do të debutojë në pistë këtë sezon në dhjetor, në garat e shtëpisë në pistën e Lake Louis. Për sa i përket rekordit të 86 fitoreve, ajo shton: "Nëse do të arrija ta thyjeja, do të ishte një mrekulli, një ëndërr që bëhet realitet. Nëse jo, nuk ka

problem, imazhi i karrierës sime nuk do të priset nga kjo gjë. Unë jam ende skiatorja femër më e suksesshme në histori", ka deklaruar Vonn, që këtë sezon do të marrë pjesë vetëm në disiplinat e supergjigantit dhe zbritjes së lirë.

SHKURT

UFC-ja pezullon McGregorin dhe Khabibin

Komisioni i Sporteve të Nevadës konfirmoi pezullimin e përkohshëm të Conor McGregor dhe Khabib Nurmagomedov për incidentet që ndodhën pas ndeshjes mes tyre në UFC. Dënimi do të hyjë në fuqi të hënën dhe do të zgjasë minimumi deri më 24 tetor, atëherë kur do të mbahet një seancë dëgjimore ku do të përcaktohet dënimi për dy luftëtarët. Pas këtij lajmi, Khabib ka reaguar duke thënë se do ta lërë UFC-në nëse do të pezullohet miku i tij Zubaira Tukhugov, i cili hyri në oktagon dhe goditi McGregorin pas përfundimit të ndeshjes. "Nëse vendosin që ta heqin nga UFC-ja, ta dinë që do të iki edhe unë. Ne kurrë nuk i braktisim vëllezërit tanë në Rusi. Ndeshjen që kishte për të zhvilluar ia anuluan, tani duan edhe ta largojnë nga UFC-ja. Harrojnë që ishte irlandezi ai që goditi i pari me grusht", shkruan Khabib në rrjetet sociale.

Rooney: Messi dhe Barça janë më të mirët në botë

Pavarësisht prej ndarjes së dhomës së zhveshjeve disa vjet me Cristiano Ronaldo, sulmuesi i njohur anglez, Wayne Rooney, e bëri të qartë se cili është më i miri në botë për të. Fjala është për Lionel Messin, yllin argjentinas të Barcelonës. Lojtari i DC United dha një intervistë për "The Sun", ku nënvizoi: "Messi bën pak nga gjithçka. Ju mund ta shihni atë që nga shënimi i golave deri te një mesfushor i pastër. Pra, ai është ndoshta më i miri". Nga ana tjetër, Rooney theksoi se Cristiano Ronaldo ka ndaluar të jetë një lojtar ofensiv krahu dhe është bërë më sulmues: "Në vend se të përballet me rivalët gjatë gjithë kohës, ai luan në zonë dhe shënonte gola". Rooney, gjithashtu, kujtoi rastet në të cilat luajti kundër Barcelonës së Pep Guardiols, e cila i mposhti ata në dy finalët e Ligës së Kampioneve. Në këtë pikë, ai shtoi: "Nëse këto ndeshje do të ishin kundër ndonjë skuadre tjetër, përveç Barcelonës, do të kishim ëndërruar fitimin e tyre. Në sytë e mi, Barça është skuadra më e mirë në histori dhe Leo Messi është lojtari më i mirë. Ajo që bën ai është e pabesueshme. Messi, thjesht ka pak gjithçka".

Vertongheni mungon deri në dhjetor

Lajme aspak të mira për mbrojtësin e Tottenhamit, Jan Vertonghen, i cili do të mungojë për një kohë të gjatë për shkak të një dëmtimi. 31-vjeçari, i cili u lëndua në sfidën ndaj Huddersfieldit më 29 shtator, do të qëndrojë jashtë fushave të blerta të paktën deri në fund të muajit dhjetor, duke përjashtuar kështu një rikuperim të futbollistit para kohës së përcaktuar.

Silva: Jam lojtar i Milanit

Andre Silva është duke kaluar një moment shumë të mirë te skuadra e Sevilias dhe shkëlqimi nuk po mungon as te Kombëtarja e Portugalisë. Sulmuesi ka shënuar dy gola në Ligën e Kombeve për Portugalinë e cila kryeson grupin me pesë pikë. "Jam shumë i lumtur për golin dhe është një moment special për mua, por e rëndësishme ishte t'i merrim tri pikët", ka thënë Silva për "Sport Mediaset". Ndërsa ai sjell edhe një herë në mëndje se marrëveshja midis Milanit dhe Sevilias është një huazim me mundësinë e blerjes teksa thotë: "Jam shumë i lumtur që luaj te Sevilla, por unë jam një lojtar i Milanit. Unë nuk e di se çfarë do të sjellë e ardhmja, por le të presim dhe të shohim se çfarë do të ndodhë".

Henry, afër marrëveshjes me Monacon

Ish-sulmuesi i Arsenalit dhe Kombëtares së Francës, Thierry Henry, shumë shpejt mund të emërohet trajner i skuadrës së madhe franceze Monaco. Mediet e huaja raportojnë se Henry të shtunën do të nënshkruajë me Monacon, për t'u bërë trajner i kësaj skuadre. Henry te Monaco do të zëvendësojë të shkarkuarin Leonardo Jardim. Bisedimet mes Monacos dhe Henrys janë në një fazë të avancuar dhe të shtunën pritet të finalizohet gjithçka, me legendën franceze që do të largohet nga pozita e zëvendëstrajnerit te Belgjika, për ta marrë drejtimin e tetë herë kampionëve të Francës.

U bënë 10 vjet nga ndarja e më të dashurit tonë



Milaim H. Misini

(20.04.1938-13.10.2008)

Vdekja të ndau nga Jeta, por jo nga zemrat tona.

Ishe bashkëshort, baba, vëlla, gjysh e vjehërr shumë i dashur.

E përkujtojnë: Familja Misini nga Prishtina dhe Korretica e Ulët.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtorija për Arsimit / Department of Education

Nr. 544/2018
Di: 12.10.2018

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Nenit 5 (shkronja c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Rep. së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 17 (shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar në Rep. e Kosovës Nr. 04/L-032, të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, të UA të MASHT 10/2018 si dhe në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore, Drejtoria Komonale e Arsimit në Skenderaj, shpall:

Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2018/2019

Nr.	Niveli	Pozita	Institucioni	Vendi	Pensionim / Zëvendësim	Nr. i orëve	Nr. i pozitave
1	Shfmu	Edukatore për parashkollor	"Fehmi Rama"	Likoc	Zëvendësim - deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë	Normë e plotë	1
2	Shfmu	Mësimdhënës/e për Edukatë Muzikore	"Kuvendi i Drenicës" "Ismet Uka"	Abri e Poshtme Ticë	Vend i lirë	10	1
3	Shfmu	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	"Drenica" "Malush Ahmeti" "Elena Gjika" "Ismet Uka" "Fehmi Rama" "Kuv. i Drenicës"	Polac Rezallë Makërmal Ticë Likoc Abri e Posht.	Vend i lirë	6 2 2 2 2 2	1
4	Shfmu	Punëtor teknik	"Fehmi Rama"	Likoc	Pensionim	Normë e plotë	1
5	Shfmu	Punëtor teknik	"Ismet Uka"	Ticë	Vend i lirë	Normë e plotë	1

Kushtet: Për vendet e punës nga 1 deri 3, në të dy nivelet (shkolla fillore dhe shkolla të mesme të ulëta) kandidatët duhet ta kenë të kryer fakultetin - drejtimi përkatës sipas Normativit 10/2018, ndërsa në mungesë të kësaj të kualifikuar vijmë kandidatët e tjerë, të drejtimit të përfaqëta, që i plotësojnë kushtet më së miri.

Zgjedhja e kandidatëve për mësimdhënës do të bëhet në bazë të nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, UA 10/2018 si dhe në bazë të rezultateve të panel-intervistës, me shkrim dhe me gojë.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas Udhëzimit administrativ nr. 10/2018 për Normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm.

Për Intervistën me gojë dhe me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë, sipas nenit 4 të UA 17/2009.

Kandidatët e listës së ngushtë me shkrim dhe me gojë do të ftohen në telefon.

Për konkurrim, kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin:

- ❖ Diploma dhe një kopje e vërtetuar e diplomës;
- ❖ Kopja e letërnjoftimit;
- ❖ Vërtetimin për punë nga gjykata;
- ❖ Certifikatën e gjendjes shëndetësore (në rast se pranohet);
- ❖ Certifikatë trajnimi - nëse keni;
- ❖ Përvoja e punës - nëse keni;
- ❖ Referencën e punës - ata që kanë përvojë pune;
- ❖ Aplikacioni merret dhe dorëzohet në objektin e Komunës, kati i parë, sporteli nr. 13;
- ❖ Kandidatët mund të konkurrojnë në shtëpi në dy shkolla;

Kushtet për pozitat numër 4 dhe 5:

- ❖ Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- ❖ Të kenë të mbaruar Shkollën e Mesme;
- ❖ Përvoja e punës e preferuar;

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ❖ Aplikacioni
- ❖ Diploma e shkollimit
- ❖ Certifikatën që nuk është nën hetime
- ❖ Letërnjoftimin (kopje)

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuar nga MASHT.

Fillimi i punës për vendet e lartcekura nuk do të jetë domosdoshmërisht me datën e shpalljes së rezultateve, por varësisht nga vendi i punës në shkollë (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.

Rezultatet e konkursit do të shpallen në webfaqe të Komunës së Skenderajt.

Dokumentacioni nuk kthehet.

Afati i konkursit mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë dhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Skenderajt.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Univerziteti Bolnička i Klinička Služba Kosovo- Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Spitali i Përgjithshëm, General Hospital, Opšta Bolnica, Genel Hastane

"Prim. Dr. DAUT MUSTAFA" - Prizren



Nr./br./nr 8/28
Datë/Datum/Tarih : 12.10.2018

Lënda/Predmet/ Konu: Anulim i pjesërishtëm i konkursit /delimicno otkazivanje oglasa / Kismi ilan iptali
Anulim e pjesërishtëm i Konkursit publik

Anulohet pjesërisht Konkursi nr. 8/24, i datës 17.09.2018 vetëm për pozitën 3 - bachelor laborant, teknik i lart laborant (dy) pozita.

Delimicno ponistenje Javnog Oglasa

Delimicno anulira se Javni Oglas br. 8/24, datum 17.09.2018, samo za poziciju br.3- bachelor laborant, vise tehnicki laborant (dva) pozicija.

Kamu ilaninin kismi iptali

8/24 sayılı 17.09.2018 tarihli, 3 nr. Laboratuvar teknisyeni lisansı (bachelor – 2 (iki)) konunun kısmen iptali ilan edilmiştir.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Astrit Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMM "Luciano Motroni" Prizren

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Raman Dilji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agnesa Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMGJ "Remzi Ademaj" Prizren

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbraja konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Isak Mazrek shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Anadolu" Mamush

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuar i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

